4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në

Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nëshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Hyrje

Albpetrol, si një prej aktorëve kryesorë në tregtinë e naftës në Shqipëri, me një histori të gjatë dhe të pasur në menaxhimin e burimeve të naftës. Albpetrol sh.a. është shoqëria shtetërore e themeluar më 6 Prill të vitit 1999, dhe që nga themelimi ajo trashëgoi të gjitha asetet dhe vendburimet e naftës në Shqipëri.

Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit ndërsa shoqëria ushtron aktivitetin e saj edhe në qendrat e prodhimit në Fier, Ballsh, Kuçovë, Patos etj. Albpetrol sh.a është në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Situata Aktuale dhe Sfidat

Nisur nga aktiviteti si dhe shtrirja gjeografike e ndërmarrjes duhet thënë paraprakisht se numri, kompleksiteti i aseteve është një sfidë e vecante për Albpetrol. Vec mbajtjes së një regjistri unik qendror të aseteve, sfidë tjetër në këtë fushë është inventarizimi, perditesimi i veprimeve me asetet, mirëmbajtja e tyre si dhe ndjekja në vazhdim të nderhyrjeve përmirësuese.

Vec veprimeve që lidhen me asetet, problematike ditore paraqet edhe mbajtja e librave që lidhen me inventaret e shoqërisë, e në mënyrë të vecante të inventareve që shërbejnë si pjesë këmbimi ose pjesë e konsumueshme të makinerive. Krijimi i kalendarit të nderhyrjeve në asete, planifikimi i atyre parandalues si dhe korrigjuese është gjithashtu një sfidë për punën e përditshme në këtë fushë.

Duke konsideruar problematiken e mesiperme, përgjatë vitit 2018 u realizua një nderhyje fillestare në këtë fushë dhe është punuar për krijimin e një libri të përbashkët asetesh, i cili synonte në:

-
- 1) krijimin e nje baze te dhenash te aseteve,
 - 2) sakesimi i vleres kontabel per to;
 - 3) krijimin e procedurave standarde elektronike ne mirembajtjen; si dhe
 - 4) gjurmimi ne paisje PDA i aseteve, ku secili prej tyre do te kishte nje kod unik elektronik.

Sistemi, prej kohesh nuk ka nje kontrate te mbeshtetjes teknike dhe te garancise, eshte tashme vjeteruar dhe baza e te dhenave dhe operimi eshte shume i pjesshem. Si rrjedhoje edhe te dhenat nuk jane perditesuar.

Nevoja për permesime dhe shtesa te sistemit

Nisur nga gjendja aktuale, si dhe nevoja per perdorimin e gjere e te sigurte te sistemit, ai kerkohet te perditesohet me teknologjine e fundit ne treg ne te gjithë komponentet si ne nderfaqen web, bazen e te dhenave, aplikimit te teknologjive te fundit te shkembimit te te dhenave rest API. Sistemi duhet te jete operativ si brenda rrjetit IT te Albpetrol ashtu edhe nga jashte tij. Ai duhet te aksesohet ne cdo kohe dhe ne cdo vend prej ekipeve te mirembajtjes dhe te inventarizimeve ne te gjithë territorin. Per te garantuar sigurine disponueshmerine e te dhenave, sistemi kerkohet te jete i pershtatshem per cloud si dhe backup te informacionit te kryhet ne cdo kohe ne serverat fizike te rrjetit te brendshem te Albpetrol.

Ne menyre te vecante kerkohet qe sistemi te jete plotesisht i sigurte ne akses, dhe te dhenat te ruhen ne dy ambiente te ndara nga njeri tjetri,

Per te ofruar nje shkalle te larte te sigurise, kerkohet qe sistemi dhe te dhenat te mundet te ruhen njekohesisht ne dy vendndodhje, nje ne server te Albpetrol dhe ne servera cloud te prodhuesit te sistemit. Aksesit ne sistemin cloud te prodhuesit duhet te aksesohet vetem nga Albpetrol, dhe vete ofertuesi i sistemit te jete pergjegjes per te gjitha ceshtjet e sigurise qe lidhen me aksesin, sherbime te perditesimit si dhe mbrojtjen nga sulmet. Perditesimi me versionet e fundit te os, db si dhe aplikimit kerkohet te kryhet ne menyre automatike, nga prodhuesi.

Vec perditesimit automatik te teknologjise, kerkohet qe sistemi te pasurohet me mjetet te fundit qe jane sot ne treg si:

- aksesit online i sigurte i sistemit, brenda dhe jashte institucionit;
- planifikimi i sherbimit te mirembajtjes;
- perdorimi i versionit mobile dhe pda per akses ne cdo kohe nga skuadrat e mirembajtjes ne terren; keshtu qe komunikimet e detyrave si dhe plotesimi i raporteve te mirembajtjes dhe nderhyrjeve te jene plotesisht te aksesueshme ne paisje mobile, PDA, Ipad etj.
- plotesimi i te dhenave te aseteve me vendndodhjen gjeografike si dhe paraqitja e planit te nderhyrjes ne formen e nje rruge/rrjedhe levizjesh ne harte;
- shtimi i funksioneve te raportimit
- krijimi e nje rregjistrimi te blerjeve te paisjeve dhe te inventareve;
- percaktimi i vendndodhjeve ne magazine per cdo element te inventarit;
- administrimi i inventareve si dhe urdherave te levizjes se tyre direkt nga PDA
- krijimi i mundesive per ruajtjen e kartelave teknike ne formen e manualeve teknike ne nje arkive elektronike dokumentare;
- kriimi i nje sistemi analize dhe raportimi qe do te marre dhe perpunoje te dhena e kryeje analiza nga te gjithë modulet ne sistem;

Me konkretisht nje liste e funksione te tjera, qe kerkohet te zbatohen, jane si meposhte:

-
- 1) Zbatimi i nje sistemi administrimit te brigadave te mirembajtjes te tipit (field operation) i cili te jete plotesisht mobile;
 - 2) Lidhja e sistemit te mesiperm me sistemin e raportimit te difekteve dhe nevojave per nderhyrje, qe do te mundesonte njoftimin e brigadave te mirembajtjes ne kohe reale per nevojat per nderhyrje dhe asistence teknike;
 - 3) Administrimi i inventareve me vendndodhje fizike brenda magazines, si dhe automatizimi i veprimeve ne magazine me paisje PDA dhe Barcode.
 - 4) Ruajtja e dokumentave personale te asetave ne dosjen teknike perkatese;
 - 5) Zbatimi i nje sistemi raportimi dhe analizes me te dhena nga te gjithë modulet;

Per kete, qellimi i projektit percaktohet si perditesimi i sistemit ne cloud, arritja e nje shkalle te larte sigurie te operimit si dhe shtimi i funksioneve qe lidhen me administrimin e mjeteve.

Qëllimi i Projektit

Qellimi i kontrates eshte permiresimi i sistemeve ekzistuese, forcimi i sigurise se sistemeve si dhe zgjerimi i saj me funksione te reja.

Rritja e shkalles se sigurise mendohet te kryhet nepermjet:

- Krijimit te nje versioni te sigurte, perditesuar te bazeve se te dhenave, te aplikimit, sistemit te operimit;
- Hostimit te sistemit ne cloud dhe ne serverat e brendshem te Albpetrol, dhe rrjedhimisht ruajtja e te dhenave ne dy vende;
- Operimit te sistemeve te mbrojtjes se sistemit cloud direkt nga prodhuesi, duke aplikuar mjetet e fundit te sigurise kibernetike;
- Ndertimi i profileve te avancuara te kontrollit te aksesit te perdoruesve duke perfshire kufizime ne nivel:
 - funksionesh ne sistem,
 - strukturash organizative te Albpetrol, si dhe
 - *dataset* (grup te dhenash specifike).

Ndersa funksione kryesore shtese do te jene:

- Administrimi dhe planifikimi i nderhyrjeve ne terren ne aseteteve, direkt nga sistemi dhe me akses online kudo dhe ne cdo kohe;
- Administrimi i magazinave me vendndodhje fizike, si dhe automatizimi i veprimeve me paisje PDA.
- Zbatimi i nje moduli te vecante per administrimin e blerjeve, i lidhur direkt me modulën e inventarit per perditesimin ne kohe reale te planifikimit te mjeteve te kembimit ose te konsumit mbi asetet;
- Zbatimi i nje sistemi raportimi dhe analizes me te dhena nga te gjithë modulet;

Siguria

Sistemi kerkohet shkalle te larte sigurie:

- Siguria e të Dhenave: Masa të forta të sigurisë për të mbrojtur të dhënat teknike dhe te operimit te mjeteve;
- Identifikimi i sigurte i perdoruesve ne sistem, nepermjet aplikimit te metodologjise se identifikimit te shumfishte (MFA, *Multifactor-Authentication*);
- Përshtatshmëria me Rregulloret Ligjore, Sigurimi që të gjithë proceset janë në përputhje me rregulloret per administrimin e asetave/mjeteve, standardet fiskale si dhe nevojave te vecanta per kontrollet teknike dhe sigurimin e mjeteve te transportit.

Per evitimin e rreziqeve qe lidhen me sisteme te reja IT, sigurine e aksesit si dhe te te dhenave kerkohet qe sistemi i permiresuar te ruhet ne dy vende te sigurta lokal ne ambjentin e serverave virtual te Albpetrol si dhe *Cloud* ku te mbrohet nga prodhuesi me mjete te avancuara. Per me shume, ky sistem

duhet te perditosohet periodikisht cdo muaj nga vete prodhuesi. Perditesimi duhet te perfshije te gjithë elementet qe lidhen me sistemin e operimit, bazen e te dhenave, ambjentin e aplikimit si dhe funksione te reja te periudhes.

Aplikimit te sistemit *cloud* kerkohet qe shkalla e operimit te sistemit te jene e nje shkalle te larte, mbi 99.8% dhe e pavarur nga siguria, interneti apo gatishmeria e infrastruktures se brendshme te ALBPETROL.

Qëllimi i kësaj kontrate shërbimi,

- **Instalimi i sistemit te permiresuar.** Ky sistem do te duhet te instalohet ne 2 ambjente, server dhe Albpetro si dhe cloud te prodhuesit. Sistemet duhet te shkembejne te dhena ne menyre automatike dhe te garantojne shkalle te larte te sigurise se te dhenave, thuaj 100%. Instalimi duhet te kryhet mbi versione te reja te gjithë elementeve te aplikimit. Ne procesin e instalimit duhet te kryhen te gjithë parametrizimet dhe lokalizimet e nevojeshme.
- **Pershtatja e proceseve te albpetro dhe migrimin e te dhenave.** Pas instalimit, sistemi duhet te parametrizohet sipas nevojave te Albpetro dhe me pas kerkohet te kryhen migrimi i te dhenave. Te dhenat do te jepen nga Albpetro dhe kerkohet qe ato te konfirmohen nga grupi i punes si perpara ashtu edhe pas migrimit. Cdo funksion i ri apo ekzistues duhet me pas te kaloj nje proces verifikimi dhe kontrolli per te konfirmuar perputhshmerine me nevojat e Albpetro.
- **Operimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit.** Pas zbatimit të sistemit kërkohet mbështetje teknike mbi sistemin/modulet. Per instalime prane Albpetro, mirembajtja dhe monitorimi i operacioneve te ruajtes si dhe siguria e aksesit ne rrjet do te kryhet nga personeli Teknik i Albpetro.
- **Hostimi, backup ne infrastrukturën mix cloud dhe ne vend.** Te dhenat dhe sistemet duhet të ruhen në dy ambjente ne cloud dhe ne server te Albpetro. Operatori ekonomik veç hostimit duhet të sigurohet edhe për komponentët e tjerë që lidhen me sigurinë, backup si dhe lidhjen internet të sigurtë. Ambientet cloud të operimit te sistemeve si dhe ato te backup duhet të jenë brenda EU's.
- **Trajnimi i personelit të ALBPETROL.** Krahas shërbimeve të mësipërme, shërbimi kërkohet të përfshijë edhe çështje të rëndësishme që lidhen me trajnimin e vazhdueshëm të personelit. Per kete, vec trajnimit si pjese e zbatimeve dhe sherbimeve fillestare kerkohet qe minimalisht 1 here ne vit, te kryhet trajnim perditues i personelit te Albpetro.

OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është permiresimi i sistemit te administrimin te mjeteve me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në të gjithë komponentet dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem. Sistemi duhet të mbështetet në teknologji modern, te versionit te fundit e paisur me shkalle te larte automatizimi (lidhje midis moduleve) si dhe raportimi inteligjent, duke minimizuar nevojën per burime te brendshme dhe minimizuar gabimet qe shoqerojne aktivitetin manual.

Komponentët kryesorë të sistemit, të cilët janë edhe objekt direkt i këtij shërbimi janë:

- Moduli per administrimin e porosive apo urdher blerjeve** duhet te realizoje hedhjen ne sistem te gjitha porosive per blerje te aseteve ose te inventareve. Ky duhet te komunikojë ne menyre te drejteperdrejte me modulën e inventareve dhe duhet te shkembej info: Per cdo inventar ne sasine minimale duhet te krijojë nje kerkese per blerje; dhe per cdo urdher blerje te inventareve duhet te perditesoje sasine me nje kollone te vecante ku te pasqyroje sasine ne pritje (porosi), se bashku me kohen e perafert te mberritjeve te artikujve ne porosi.
- Moduli për menaxhimin e aseteve,** qe sherben per ruajtjen e te dhenave teknike dhe financiare per aseteve. Sistemi duhet ne menyre te vecante, te evidentojë te gjitha veniet ne pune ose daljet nga perdorimi, transferimin midis vendndodhjeve, personave apo njesive qe operojne apo administrojne mjetet; Ky modul duhet te realizoje gjithashtu edhe ruajtjen vlerave te assetit si dhe procedurave kontabel qe lidhen me amortizimin, vleresimin apo rivleresimin pozitiv ose negative te vleres kontabel;
- Moduli për administrimin e inventareve** administron proceset qe lidhen me administrimin e magazinave, vendodhjeve apo rafteve ne sistem. Moduli duhet te mundesoje rregjistrimin e te dhenave per artikuj dhe kategorine e tyre. Moduli duhet te mundesoje proceset qe kane te bejne me

hyrje/daljet, transferimin midis vendndodhjeve. Levizjet ne magazine te mundesohen plotesisht nepemjet paisjeve PDA. Moduli duhet te mundesoje edhe ndjekjen e sasive minimale ne baze te magazines si dhe krijimin automatik te urdher transferimeve ose te blerjeve nese e nevojeshme per plotesimin e sasise minimale. Moduli duhet te jete plotesisht i integruar me ate te mirembajtjes se paisjeve (aseteve) per regjistrimin e flete daljeve ne rastet e perdorimit per ceshtje te mirembajtjes.

- D. **Moduli per administrimin e sherbimeve te mirembajtjes** duhet te mundesoje ruajtjen e sherbimeve te mirembajtjes parandaluese ose riparuese per cdo asset. Cdo nderhyrje kerkohet te permbaje brenda vetes edhe artikuj ose inventaret e konsumuar, sebashku me vleren e inventareve apo sherbimeve.
- E. **Moduli per administrimin e nderhyrjes ne vend (field operation)** duhet te mundesoje ruajtjen dhe sherndarjen e urdherave te punes pergjate mirembajtjes ne vend te aseteve. Keto urdhera duhet te shperndahen automatikisht per brigadat e mirembajtjes. Sistemi duhet te jete i asesueshem ne paisje PDA ose mobile dhe brigadat kerkohet te njoftohen automatikisht. Sistemi duhet te ofroje mundesine e ruajtjes se vendodhjeve te asetit ose te vendodhjes ku kerkohet nderhyrje/asistence. Cdo vendndodhje duhet te demostrohete ne harte, per te lehtesuar gjendjet e asesit. Cdo nderhyrje duhet e pasqyrohet ne sistem direkt nga paisje mobile/pda. Dokumentimi duhet te lejoje hedhjen e artikujve ose inventaret e konsumuar, sebashku me vleren e inventareve apo sherbimeve si dhe konfirmimin nga kerkuesi i sherbimit.
- F. **Modulin e arkives se dokumentave teknike**, mundeson ruajtjen ne forme elektronike te dokumentacionit te mjeteve. Cdo dokument, mundet te percaktohet te drejtat per perdorues/rol qe ka te drejte. Sistemi duhet te kryej njoftime per ndryshim te drejtave apo per perditesime ne dosje teknike te assetit.
- G. **Moduli i raportimit dhe i analizes**, mundeson raportimin ne kohe reale te te dhenave, dergimin e raporteve ne rruge elektronike dhe mundeson menyra te ndryshme te raportimi si ajo tabelare, grafike, dashboard, etj.. Ne menyre te vecante analizat dhe reported me te dhena nga i gjithe sistemi duhet te mundesohet ne ne forme raportesh PDF dhe ne format te editueshem excel, csv, etj. ku perdoruesi do te mundet te kryej analiza shtese.
- H. **Moduli i administrimit te ceshtjeve (Trouble Ticket System)** duhet te mundesoje mbledhjen e kerkesave per nderhyrje qe kryhen direkt nga perdoruesit e mjeteve (aseteve). Moduli duhet te perfshije edhe procesin e monitorimit dhe te ndjekjes se ecurise se nderhyrjes riparuese. Ndjekje e kohes se nderhyrjeve dhe e afateve te pergjigjes (se brigades e mirembajtjes) duhet te percaktohet prioriteti i ceshtjes.

Regjistrimi i fillestar i të dhenave në sistem do të realizohet ne dy menyra:

- Marrja prej sistemeve ekzistuese; ose
- Marrje nga burime te tjera informacioni qe gjenden prane Albpetrol.

Ne cdo rast, ky proces duhet te realizohet me angazhimin e grupit te punes se Albpetrol, i cili do te:

- Konfirmoje burimin e te dhenave;
- Versionin paraprak te dhenave (perpara migrimit);

si dhe, ne perfundim te migrimit:

- do te konfirmoje saktesine.

Procesi i migrimit i te dhenave do te kryhen nga operatori ekonomik. Ndersa te dhena qe nuk ekzistojne, ose cilesia e informacionit aktual nuk eshte e larte, do te duhet te hidhen ne menyre manuale prej perdoruesve qe mbulojne funksionet, prane Albpetrol.

Në kuadrin e zbatimit te projektit, ofertuesi ekonomik duhet të realizojë:

- Analizën e gjendjes aktuale;
- Hartimi i një dokumenti përshkrues të sistemit, ndryshimeve per cdo modul (vecanerisht ato te reja);
- Implementimin e moduleve ose te ndryshimeve, migrimin e te dhenave.

- Trajnimet për të gjithë stafin që do të përdori këtë sistem (të ndara për përdoruesit e sistemit dhe administratoreve të sistemit);

Modulet e mësipërme duhet të jenë të integruara me njëra tjetrën dhe standartizojnë dhe automatizojnë procedurat e administrimit të burimeve njerezore të ALBPETROL. Integrimi midis moduleve sjell evitim të hedhjes së dyfishtë të të dhënave, dhe mundëson kontrollin e informacionit të dy ose me shumë drejtime (module).

SUPOZIMET DHE RISQET

Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti do të bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti
- Bashkëpunimi midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit
- Vënia në dispozicion të infrastrukturës së nevojshme për implementimin e projektit
- Alokimi i burimeve njerezore të nevojshme për implementimin e këtij projekti
- Përcaktimi i saktë i buxhetit të nevojshëm për realizimin me sukses të projektit

Risqet

Është i rëndësishëm impenjimi i plotë i grupeve të punës pjesëmarrëse (nga të dyja palët) në zhvillimin e projektit. Disa nga faktorët që do të mund të riskonin ecurinë e projektit:

- Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të projektit
- Vlerësimi jo i saktë i situatës aktuale të sistemit dhe infrastrukturës
- Mospërcaktimi i saktë i burimeve të nevojshme për realizimin e projektit
- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e moskoordinimit të punës mes pjesëtarëve të përfshirë në këtë proces
- Mungesa e bashkëpunimit me palët e treta për vënien në dispozicion të të dhënave dhe *web service*-ve përkatëse.
- Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik në të tilla projekte.

MBULIMI TEKNIK

Ky shërbim duhet të përfshijë (në përputhje me këto Terma Reference) në mënyrë të domosdoshme:

- Mirëmbajtjen e programeve bazë;
- Zbatimin e moduleve shtesë;
- Migrimin dhe hostimin e moduleve të sistemit në cloud tek infrastruktura e sigurte cloud e prodhuesit të sistemeve; Instalimin e moduleve të perditesuara ne serverat e Albp petrol si dhe mundësimi i shkëmbimit të të dhënave midis dy instalimeve të ndryshme.
- Përditesimin falas të sistemeve nëpërmjet patches, në varësi të nevojave të ALBPETROL si dhe të nevojave për përditësim, nga vetë prodhuesit e programeve aplikative. Përditësimi i sistemit duhet të kryhet në mënyrë të automatizuar dhe pa ndërhyrjen e përdoruesve të sistemit. Në mënyrë të vecantë përditësimet duhet të kryhen edhe lidhur me patchet apo instalimet e nevojshme që dalin si nevojë e rritjes së sigurtisë së sistemeve.
- Trajnimin e personelit për sistemet
- Konsulencë në çështje që lidhen me procedurat e përdorimit të sistemi, si dhe përputhja me kërkesat specifike të ALBPETROL,

KOMPONENTËT KRYESORË TË SISTEMIT

Sistemi duhet t'u krijojë mundësi përdoruesve të regjistrojnë të gjitha aktivitetet e tyre periodike (ditore, javore, mujore etj) të veprimeve që kanë të bëjnë me aktivitetin e administrimit të burimeve njerezore.

Modulet kryesore në sistem

Modulet kryesore, përbërëse të sistemit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi
1	Moduli: Blerjet
2	Moduli: Asetet/Mjetet
3	Moduli: Inventaret
4	Moduli: Administrimit i shërbimit të mirëmbajtjes
5	Moduli: Administrimin e nderhyrjes në vend (field operation)
6	Moduli: Raportimit dhe analizës së tipit BI
7	Moduli: Arkives së Dokumentave teknike të Aseteve
8	Moduli: Administrimit të ceshtjeve (<i>Trouble Ticket System</i>)

Funksionet dhe lidhjet kryesore midis sistemeve

Më poshtë përshkruhen funksionet kryesore, në sistem.

(a) Specifikimet Teknike

Sistemi i administrimit të mjeteve duhet të mundësojë krijimin e një baze të dhënash të përqendruar të asetëve, inventareve si dhe operacioneve që lidhen me to. Ky sistem duhet të jetë një zgjidhje e gjerë, e plotë dhe të mundësojë mbështetje për kompani globale të tipeve të ndryshme të industrisë. Sistemi duhet të mbështetet në teknologji modern, shkallë e lartë automatizimi, sistem të avancuar të raportimit inteligjent.

Te përgjithshme

- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një zgjidhje cila të mbështetet plotësisht në arkitekturë WEB dhe të jetë e pavarur nga platforma e sistemit operativ.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një zgjidhje që sistemi të jetë i bazuar në platformën WEB, me mundësi aksesimi nga çdo klient windows, Linux, Apple, Android etj.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një zgjidhje në të cilën duhet të mbështetet dhe të jetë i hapur për teknologjinë e shërbimeve WEB (WEB Services).
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një mjet për integrimin me sisteme të tjera duke përdorur teknologji të avancuara *Rest API* nepermjet shkëmbimit të informacionit në formate XML, Json, etj.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë në sistem që të jetë në gjendje të menaxhojë në rrugë informatike politikat/te drejtat dhe proceset e punës së stafit në përputhje me pozicionet e punës.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të ketë ndërfaqe në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të jetë i bazuar në një sistem operimi open source (Linux, Unix, etj.).
- Sistemi duhet të jete i ndertuar për të operuar në cloud, si dhe të lejoje instalimin në serverat lokale të Albpetrol. Sistemi duhet ofrojë mundësinë e shkëmbimit të dhënave nga cloud në sistemet lokale dhe anasjelltas.

- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që baza e të dhënave për sistemin të jetë i bazuar në platforme open Source. Platforma që do menaxhojë dhe do mundësojë bazën e të dhënave nuk duhet të kërkojë licensë të specifikuar për funksionimin dhe mbarëvajtjen e tij.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që platforma e menaxhimit të bazave të të dhënave (databaza) e përdorur nga sistemi duhet të jetë ndërtuar në sistem Cluster për të mundësuar qëndrueshmëri të lartë në çdo kohë, si dhe të suportoje operimin në cloud dhe në instalime në vend (on-premise).
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi duhet të ketë mundësi që të instalohet në sisteme ekzistuese virtuale të Albpetrol.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të instalohet dhe të jetë i aksesueshem brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së kontratës. Sistemi duhet të ketë funksionet baze si aksesimi dhe navigimi në aplikacion, menaxhimin e userave etj.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të sigurojë të gjitha shërbimet e moduleve të sipërpërmendura, brenda 4 muajve nga data e lidhjes së kontratës.
- Sistemi duhet të mundësojë akses në vartësi të pozicionit dhe rolit të përdoruesve
- Sistemi duhet të mundësojë login të unifikuar në të gjitha funksionet (SSO - Single Sign ON);
- Sistemi duhet të jetë i aksesueshem nga çdo paisje, përfshirë edhe ato mobile;
- Sistemi duhet të ofrojë version mobile app për instalim në aparatet mobile të punonjësve.
- Profilët e përdoruesve si dhe shkalla e aksesit në sistem, duhet të jenë të modifikueshme (për shpallje, drejtues, burime njerzore)
- Sistemi duhet të mundësojë krijim të pakufizuar punonjësve, në mënyrë të vecantë të lejojë grupimin sipas njësive organizative.
- Sistemi duhet të mundësojë përcaktimin e njoftimeve, të detyrave apo të funksioneve në një përdorues në sistem, ose në një grup përdoruesish.
- Sistemi duhet të mundësojë kërkimin e përgjithshëm (fuzzy) në bazë të të cilit, në çdo hedhje për search sistemi duhet të kthejë jo vetëm të dhënat që plotësojnë plotësisht kriterin e kërkimit por edhe ato të cilat 'i përafrohen' tekstit në kërkim.
- Sistemi duhet të ofrojë mjete për ndërtimin (dhe modifikimin) e workflow që lidhet me proceset e brendshme. Këto ndryshime mund të jenë si në hapa ashtu edhe në personat, rolet apo njësitet përgjegjës për secilin nga hapat.
- Sistemi duhet të mundësojë kërkim (search) jo vetëm në të dhëna baze të strukturuar por edhe në dokumentat e lidhur attached që janë në formatin PDF.
- Sistemi duhet të lejojë përdoruesit të përdorin programe për editimin e tekstit, ruajtjen e dokumentave të skanuar apo digital në formë PDF, word, Excel, Imazhe etj. Në varesi të drejtave të përdoruesit, duhet të lejojnë të kryejnë ndryshime, permiresime, shtim versioni ose ndryshim kategorizimi të dokumentit.
- Sistemi duhet të jetë i hapur për aplikimin e teknologjive të inteligjencës artificiale, në rekomandimin e veprimeve që lidhen me burime njerzore.
- Sistemi duhet të ofrojë mjete për njoftimin e përdoruesve për ngjarje kryesore në sistem, sikurse mund të jenë datat e mbylljes së procedurave, data që lidhen me kthimin e përgjigjeve të kërkesave, realizimin e vlerësimeve periodike, etj.
- Sistemi duhet të mundësojë funksione që lidhen me kërkimin e avancuar, si dhe ruajtjen e kërkesave apo kriterëve të kërkimit për kërkimet e mëvonshme.
- Sistemi duhet të ofrojë dashboard të përbashkët për të gjithë përdoruesit. Në të mund të publikohen ngjarjet kryesore në sistem sikurse janë përditësimet në strukturë, punonjësit, vlerësimet, planifikimet e turneve, prezenca në punë si dhe procedurat e tjera.
- Sistemi duhet të mundësojë tutoriale në web që lidhen me përdorimin e sistemit.
- Sistemi duhet të mundësojë mjete për marrjen e përshtypjeve të përdoruesve si dhe mesazherise për komunikime të brendshme (përfshirë edhe përmes marrësve në sistem);

Qëndrueshmëria

- Sistemi duhet të ofrojë qëndrueshmëri, shkallë të lartë operimi dhe siguri të lartë.

- Sistemi duhet të plotësojë standardet ndërkombetare të ruajtjes së të dhënave personale;
- Sistemi duhet të ruajë integritetin dhe gjurmimin në çdo informacion të hedhur në të;
- Çdo ngjarje dhe regjistrim në sistem, duhet të regjistrohet. Bashkë me këtë, sistemi duhet të ruajë përdoruesin, datën orën si dhe vendim në të cilin u krye ndryshimi.
- Sistemi duhet të jetë i hapur për shkëmbime të informacionit me sisteme të tjera të jashtme, sikurse ai i kontrollit të hyrjeve, email, rrjete sociale për publikime të mundshme të vendeve vakante, etj.

(a) Kërkesa të përgjithshme

Sistemi i kërket të jetë një paketë e gatshme dhe plotësisht e integruar me të gjitha modulet e tjera të përfshira në projekt. Ai duhet të jetë i hapur për integritet me paketa apo aplikime të tjera të administrimit të operacioneve që ALBPETROL.

Në këtë drejtim, ky sistem kërket të përfshijë modulet/nënsistemet e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi
1	Moduli: Blerjet
2	Moduli: Asetet/Mjetet
3	Moduli: Inventaret
4	Moduli: Administrimit i shërbimit të mirëmbajtjes
5	Moduli: Administrimin e ndërhyrjes në vend (field operation)
6	Moduli: Raportimit dhe analizës së tipit BI
7	Moduli: Arkives së Dokumentave teknike të Aseteve
8	Moduli: Administrimit të çështjeve (<i>Trouble Ticket System</i>)

(a)

Sistemi i raportimit dhe administrimit të informacionit - ALBPETROL kërkon që vec raporteve standarte që lidhen me Asetet, Inventaret, Ndërhyrjet Riparuese, etj. të mundet të zbatohet një sistem të avancuar të administrimit të përqëndruar të raportimit të përgjithshëm të aktivitetit dhe të performancës.

Ky sistem, i raportimit inteligjent i tipit BI, do të ofrojë drejtuesve të ALBPETROL:

- Pamje të përgjithshme dhe të integruar të të gjithë informacionit dhe të treguesve të performancës në sistem;
- Integrim i të gjitha informacioneve që mbahen në sistemet pjesë të këtij projekti (por me mundësi zgjerimi edhe në sistem apo nënsisteme të tjerë që do të zbatohen në të ardhmen);
- Informacion kohor; të agreguar dhe analitik të ecursisë të treguesve të përgjithshëm të performancës në fushën e administrimit të aseteve;

Kërkesa Teknike të detajuara

Sistemi i administrimit të aseteve

Furnizuesi do të ofrojë një program aplikativ për menaxhimin e aseteve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes i cili do të jetë:

- Programi aplikativ duhet të jetë i lehtë në përdorim.
- Veprimet të jenë të qarta dhe të thjeshta për tu kuptuar.
- Proçeset gjatë përdorimit të jenë të shpejta dhe të kuptueshme.
- Duhet të mundësojë kryerjen dhe shfaqjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për administrimin e aseteve si dhe duke regjistruar të gjitha detajet për transaksionet që kryhen mbi të.
- Transaksionet duhet të administrohen pavarësisht vitit ushtrimor financiar.
- Moduli duhet të mundësojë transferimin e aseteve midis qenderave të kostos.

- Programi aplikativ i menaxhimit të stafit dhe shërbimeve operacionale duhet të mbajë (por jo të kufizohet) informacion të detajuar mbi:
 - Kodi i identifikues i Asetit si dhe barcode;
 - Ndertimi i strukture sipas hierarkisë (kompania, vendndodhje, impiante, paisje, mjete dhe komponente)
 - Grupi i postimit të Asetit - Funkcioni përsosur dhe me i rendesishëm i kësaj fushe është lidhja që krijohet ndërmjet asetit dhe llogarive të planit kontabel. Konfigurimet e këtij grupi duhet të kryhen paraprakisht llogarite e blerjes, shitjes, shpenzimit të amortizimit, shpenzimet e mirëmbajtjes, amortizimit të akumuluar dhe të ardhurat apo humbjet nga shitja e aseteve.
 - Aset i buxhetuar - Informacion që përcakton nëse aset do të jetë një aset i buxhetuar apo jo.
 - Sigurimi - Këtu përshihet nga një bashkësi të dhënash që përmbajnë informacione me sigurimin e asetit (lloji, arsyeja, primi, afati, etj.).
 - Të dhëna mbi garancinë si p.sh. garanci, aftësi, kushtet etj.
 - Punonjësi në ngarkim - praktikisht nëpërmjet këtij elementi mundësohet lidhja e asetit me personin përgjegjës për përdorimin/administrimin e tij.
 - Alokimi në qendrë të Kostos - Element i rendesishëm është edhe alokimi i asetit nga pikepamja financiare. Ky element përdoret për të realizuar shpërndarjen e shpenzimeve të amortizimit sipas njësive administrative/organizative.
 - Workflow i venies në përdorim - Sistemi duhet të mundësojë workflow për venien në punë të çdo asemi sipas procedurave që ka ALBPETROL.
 - Njoftime automatike- Sistemi duhet të njoftojë përdoruesit përkatës nëpërmjet email për situata të caktuara (si për shembull koha e rinovimit të garancisë, sigurimit, mirëmbajtjes periodike etj) rreth aktiveve sipas përcaktimit dhe konfigurimit që bën përdoruesi.
 - App mobile lejon të njëjtat funksione sikurse aplikimi në kompjuter desktop.
 - Veprime nëpërmjet app mobile - Punonjësi në terren pasi që skanuar BAR CODE dëto shohet në ekran informacion rreth asetit dhe aty mund të bëjë ndryshime të tekstit të ngarkojë foto.
 - App mobile duhet të operojë në kohë reale me informacionin e ruajtur në database qendrore.
 - Moduli duhet të realizojë proceset e punës të cilat janë të nevojshme për të mundësuar ciklin e veprimeve për administrimin financiar të asetit. Këto procese punë përmbledhin, por nuk kufizohen në procedurat për;
 - amortizimit financiar.
 - rivlerësimin (shtimin/pakesimin si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve).
 - veprimin e riklasifikimit të asetit.
 - Moduli duhet të krijojë automatikisht ditaret mujore për amortizimin dhe rivlerësimin e aseteve.
 - Elementet kryesore të procesit të rivlerësimit të atributëve të asetit të cilat duhet të merren parasysh gjatë ndërtimit të strukture së këtij moduli duhet të jenë :
 - Metoda e Amortizimit. p.sh. lineare, vlera mbetur, vlera e mbartur, etj.
 - Përqindja e Amortizimit.
 - grup asetesh, sipas legjislacionit apo normativave të parashikuara,
 - Data e fillimit të Amortizimit.
 - Data e përfundimit të Amortizimit.
 - Nr. i viteve.
 - Vlera e mbetur.
 - Gjendja (Shitur, dale jashtë përdorimit, Joaktiv ose Bllokuar.
 - Oendra Kostos. si dhe
 - Historiku i modifikimit.

Moduli i regjistrimit të blerjeve

Moduli i blerjeve duhet të mbështesë procedurat që lidhen me planifikimin e blerjeve të inventarit në sistem. Ai duhet të lidhet në kohë reale me modulin e inventareve nga ku do të marrë nevojën për plotësim me inventare (kur inventari është nën sasinë minimale) si dhe do të përditesojë inventarin me sasinë e re të porositur. Njëkohësisht për sasitë që planifikohen të levrohen sistemi duhet të përditesojë një kollonë të vecantë për sasinë e planifikuar.

Me konkretisht Moduli duhet te realizoje:

- Hedhjen ne sistem te urdher blerjeve. Ky document duhet te permbaje te dhenat e artikullit, kodifikimin, sasine ne blerje si dhe cmimet e rena dakord;
- Ruaj gjurme per cdo hyrje ne magazine si dhe sasine e hapur (ende te pafurnizuar);
- Te rregjistrohen te dhenat e furnitorit qe planifikohet te sjell artikujt;

Moduli i administrimit te Inventareve

Moduli i inventareve duhet te realizoje rregjistrimin dhe mbajtjen e inventareve ne magazinat e ndryshme te Albpetrol. Ai duhet e jete plotesisht i integrar me Modulet e tjera, pjese e sistemit. Me konkretisht Moduli duhet te realizoje:

- Krijimin dhe administrimin e vend-ndodhjeve ne magazina sikurse jane raftet, rrjeshtat, katet, etj. Pershire edhe zonat e perpnimit apo te ruajtjes se produkteve te vecanta sikurse mundet te jene vendodhje per palete, zona te kontrollit te mallrave ne hyrje etj..
- Per cdo artikull ne magazine, moduli duhet te mundesoje ruajtjen e numrave seriale, numrave te dergeses si dhe te datave te skadences, dhe ne veprimet ne magazine sistemi duhet te rekomandoje perdorimin e menyrave te ndryshme artikujve per levizje. Prsh. Nje nga politikat e mundshme ne sistem mundet te jete perdorimi i daljes se artikujve te hyre me heret, ose e artikujve qe kane date skadence me te afert.
- Sistemi duhet te ofroje mundesine e administrimit te nje sasie te pakufizuar magazinash.
- Duhet te percaktoje rregulla per si per hyrjen ashtu edhe per daljen ne magazine. Sikurse mundet te jene zona per inspektimin e artikujve, pregatitjen per dalje, etj. te ngjashem.
- Pregatit dhe miremban dokumentacionin per dalje dhe ne hyrje te materialeve nga magazina. Keto duhet te perfshine dokumenta ne hyrje, urdhe transferimit te brendshem, urdhera per dalje etj. Dokumenta apo operatione te tjera te planifikuara ne sistem jane inventarizimi si dhe evidentimi i diferencave.
- Operationet magazine perfshire ate te inventarizimit, levizjeve te brendshme si dhe ato te hyrje daljeve duhet te jene te administrueshme edhe nga paisje PDA. Sistemi duhet te jete pershtatur per skanim te barcode direkt nga paisje PDA.
- Per secilin nga artikujt ne magazine, sistemi duhet te lejoje percaktimin e sasise minimale dhe maksimale. Ne rast renie te sasise nen keto percaktime, sistemi duhet te krijoj nje urdher automatik per blerje ne status draft.
- Ne percaktimin e gjendes te inventarit sistemi duhet te mundesoje edhe parashikime per gjendjen ne periudha te ardhshme. Per kete sistemi duhet te mundesoje edhe mbajtjen e koheve te mundeshme te hyrjes se artikujve qe jane pjese e nje urdher blerje.

Moduli i mirembajtjes se aseteve/paisjeve

Per administrimin e mjeteve, sistemi duhet te jete i pershtatur per ndjekjen e mirembajtjes dhe te nderhytjeve. nderhyrje te tilla mundet te jene ato te planifikuara ose ato jashte radhe (riparuese) qe jane si pergjigje e difekteve ne operim. Per cdo nderhyrje sistemi duhet te mbaj gjurme te veprimtarise. Per kete sistemi duhet te mundesoje:

- Ruajtjen dhe planifikimin e nderhyrjeve;
- Ruajtjen e kosos dhe veprimtarise ne cdo nderhyrje te mirembajtjes;
- Sistemi duhet te mbaj log te sherbimeve te mirembajtjes, duke percaktuar tipin e mirembajtjes si dhe te dhena specifike teknike qe lidhen me sherbimin. Per cdo nderhyrje mirembajtjeje, sistemi duhet te mundesoje rregjistrimin e faturave, kostot se mirembajtjees, furnitoret si dhe data e garancise ne mirembajtjes.
- Sistemi duhet te lidhet me sistemin e administrimit te mirembajtjes ne terren per shkembim automatik te nevojës per mirembajtje dhe njoftimin e operatoreve apo brigadave ne terren.

- Sistemi për cdo nderhyrje mirembajtje duhet të regjistrojë statusin e nderhyrjes, kohën e raportimit, zgjidhjes si dhe të tjera të ngjashme.
- Sistemi duhet të jetë i aksesueshëm edhe nga pajisje PDA, celulare ose Ipad. Të gjitha funksionet duhet të ofrohen në mënyrë të njëjten pavarësisht mjetit të përdorur për të aksesuar sistemin.

Moduli i administrimit të nderhyrjeve në vend (*field operation*)

Moduli duhet të ofrojë lehtësi për administrimin e skuadrave të mirembajtjes së aseteve dhe të pajisjeve në terren. Ai duhet të jetë i optimizuar për përdorim në pajisje PDA, dhe mobile të cilat përdoren nga skudrat në terren. Sistemi duhet të mundësojë për këto ekipe, planifikimin, dokumentimin e nderhyrjeve si dhe dokumentin final të nderhyrjeve të realizuara. Punonjësit në terren mundet të përdorin këtë aplikim për cdo informacion apo dokumentacion shtesë që mundet të duhen me zyrat. Për këtë sistem duhet të mundësojë:

- Dizajnim të sistemi për përdorim nga pajisje mobile, PDA, Ipad të cilat janë të përshtatshme për përdorim në terren;
- Aksesin në hartë të vendodhjeve të asetit që kërkojnë për mirembajtje. Planifikimin dhe rishikimin e vizitave të mirembajtjes në bazë të optimizimit të lëvizjeve në terren;
- Mundësimin e përdorimit të mjetit të komunikimit në formë chat për të përmbledhur në një vend aktivitetet dhe komunikimet për zgjidhjen e nderhyrjes së mirembajtjes, sikurse mundet të jenë telefonatat, email, takimet, njoftimet shënime të punës në cdo detyrë ose plan nderhyrje.
- Krijimin automatik të detyrave për nderhyrje në fushë, nga moduli i raportimit të problemeve (trouble tickets) ose sistemi i administrimit të mirembajtjes.

Administrimi i dokumenteve

- Sistemi duhet të ofrojë arkivimin e dokumentave, si dhe shtimin e metadata dhe të kategorizimeve të ndryshme për cdo dokument;
- Mundësojë lidhjen e dokumentave me kartelën/dosjet e aseteve si dhe kategorizimin e dokumentave;
- Mundësojë editim dhe përpunim të dokumentave pa nevojën e programeve të treta;
- Mundësojë lidhjen e dokumentave me sisteme të tjera të dokumentacionit dhe arkives si Google drive ose Microsoft onedrive;
- Të jap mundësi të përcaktimit të drejtave në nivel dokumenti apo folder të dokumentave;
- Të ofrojë shërbimin e 'koshin' për ruajtjen e dokumentave për një minimum kohë 30 ditë pas fshirjes. *Koshi* (trash bin) do të mundësojë rikuperimin e dokumentave që janë fshirë gabimisht;
- Mundësojë dërgimin e dokumentave direkt me email apo rrugë të tjera komunikimi si whatsapp;

Menaxhimi i Përdoruesve (Users)

- Sistemi duhet të mundësojë krijimin, ndryshimin dhe fshirjen e një numri të pafundëm përdoruesish që do aksesojnë sistemin. Këta duhet të jenë punonjës, ose aplikantë!
- Punonjësit duhet të kenë akses në sistem, për të verifikuar në mënyrë të pjesshme (jo cdo ditë) të dhënat e ruajtura për ta;
- Sistemi duhet të mundësojë një shkallë të lartë *autentikimi* në sistem, që bazohet në *multifactor authentication* (MFA);
- Programi aplikativ duhet të mundësojë që të krijohen profile të ndryshme aksesesh në bazë të strukturës së kompanisë. Rolet përkatese të përcaktohen nga përdoruesi që ka pozicion më të lartë në hierarki. Menuja apo funksionet bazë duhet të shfaqen për përdoruesin vetëm atëherë nëse janë lejuar nga supervizori.

- Cdo percaktim i aksesit ne sistem, duhet te aplikohet ne kohe reale ne te gjitha modulet ne sistem. Prsh ndryshimi i strukture organizative te punonjesit te burimeve njerzore, duhet te aplikohet ne kohe reale ne kufizimin sipas pozicionit te ri ne te gjitha modulet e sistemit.

Sistemi i menaxhimit të detyrave “TROUBLE TICKET”

- Sistemi duhet te mundesoje krijimin e ceshtjeve (trouble ticket) nga cdo punonjes.
- Përdoruesit duhet të jenë në gjendje që në çështjet, të kenë mundësi të bashkëngjisin një dokument (file të ndryshme, foto, etj).
- Sistemi duhet të mundësohet menaxhimi i grupeve te mirembajtjes të cileve mund t'i caktohen çështje, duke krijuar për secilin grup një e-mail alias të veçantë, të cilën punonjesit mund ta kontaktojnë direkt.
- Çështjet/detyrat duhet të jetë e mundur t'i caktohen automatikisht në mënyrë të balancuar përdoruesve të brendshëm, në mënyrë të rastësishme, por edhe manualisht nga vetë punonjesit e brendshëm.
- Aksesit ne sistem e ceshtjeve te mirembajtjes duhet te kryhet ne nje nderfaqe te vecante, e mundeshme per t'u integruar ne faqe web te institucionit.
- Sistemi duhet të mundësojë delegimin e detyrave/ceshtjeve nëpërmjet userave të krijuar në sistem. Përcaktimi i detyrave bëhet në bazë të strukturës së krijuar duke përfshirë drejtoritë dhe personelin.
- Sistemi duhet te kete mundesine e caktimit automatik te ceshjeve ne varesi te asetit, punonjesit qe hap ceshtjen ose kategorise se ceshtjes.
- Duhet të jetë e mundur që çështjeve t'i ndryshohet statusi, p.sh. nga “Në Progres” në “E zgjidhur”.
- Sistemi duhet të mundësojë Lajmërimin me SMS dhe Email për çdo delegim apo përcaktim detyre, dhe për çdo përditësim të çështjeve që janë të hapura në këtë modul. Çdo përdorues që ka marrë një çështje në ngarkim duhet të lajmërohet në kohë reale.
- Sistemi duhet të mundësojë që të gjenerojë raporte të ndryshme grafike apo gjenerimin e tyre në file të jashtme si Excel, Word, Pdf etj.
- Sistemi duhet të mundësojë që ky modul të jetë i integruar me përdoruesit që do kenë mundësi aksesimi në këtë platformë.
- Sistemi duhet të lejojë punonjesit të shohin/ndjekin ecurine e çështjes se tyre, ta editojnë atë apo ta mbyllin nëpërmjet sistemit.
- Sistemi duhet që të ruajë të dhënat gjatë të gjithë kohës në mënyrë të sigurtë.
- Sistemi duhet të mundësojë dashboard për paraqitjen e të gjitha detyrave/çështjeve me qëllim monitorimin e performancës.

Sistemi i raportimit dhe analizes se treguesve

Pjesë e rëndësishme e projektit është ofrimin e modulit te raportimit si dhe analizes. Ky sistem duhet të mundësojë akses të integruar dhe ne kohe reale te informacionit ne te gjitha modulet ne sistem.

Ndër kërkesat për modulën e raportimit dhe analizes, përmendim:

- Sistemi i raportimit duhet të ofrojë modele të gatshme të analizës mbi modulet e vecanta si dhe menyren e paraqitjes se tyre ne nje dritare, raport te perbashet;
- Duhet të mundësohen modele të gatshme analize për modulën e të burimeve njerezore, kontratave, KPI per njesi ose punonjes, etj tregues te ngjashem. Qellimi eshte analiza e thelluar e shume dimensionale te njesive ose punonjesve, te cilet hapin ceshtje.
- Sistemi i raportimit duhet të jetë i zgjerueshëm për të krijuar vizualizime në raporte si dhe për t'u lidhur me burime të tjera të dhënash.

- Sistemi i raportimit duhet të jetë intuitiv me qëllim personalizimin e eksperiencës së përdoruesit në sisteme të ngjashme.
- Sistemi i ofruar duhet të mundësojë dashboard të gatshëm si dhe mundësinë e ndërtimit të tyre nëpërmjet një motori të avancuar raportimi.
- Duhet të mundësohet analizimi i detyrave të ndryshme me qëllim analizimin e performancës së punonjësve apo projekteve.
- Raportet duhet të paraqiten në disa lloje formatesh të ndryshme si format grafik, tabelor ose tabela pivot të cilat mund të eksportohen në formate të ndryshme si .xls etj. Frekuenca e ekstraktimit të këtyre raporteve mund të jetë javore, mujore apo vjetore.
- Lidhur me detyrat/ceshtjet sistemi duhet të mundësojë vendosjen e standardeve për skuadrat duke krijuar politikën e SLA (kohe pergjgje). SLA-të mund të krijohen në varësi të tipit të ceshtjes, personit që ka hapur ceshtje ose të prioritetit të vendosur.
- Sistemi duhet të mundësojë dërgimin e raporteve dhe të analizave direkt me email ose mjete të tjera komunikimi;

SHËRBIMI I ZBATIMIT TË SISTEMIT

Detyrat specifike

Në kuadër të zbatimit të projektit, fazat kryesore të tij janë si mëposhtme:

- **Faza I: Fillimi i zbatimit, dhe raporti i vlerësimit të gjendjes**

Në këtë fazë, operatori ekonomik duhet të bëjë vlerësimin fillestar të gjendjes, procedurat aktuale të administrimit të aseteve dhe të dhenave të ruajtura në sistemet aktuale. Operatori ekonomik duhet të mbledhë informacion mbi mjedisin aktual të aplikimit, duke përfshirë vecoritë, funksionalitetet dhe të vlerësojë volumin e vprimeve për migrim.

Pjesë e raportit është edhe ndërtimi i një plani analitik të hapave si dhe burimeve njerezore që kerkohen.

- **Faza II: Zbatimi i sistemit të perditesuar me të gjithë modulet**

Në këtë fazë, operatori ekonomik duhet të realizojë instalimin e sistemit bazë të burimeve. Ai duhet të bëjë *setup* të sistemit bazë dhe të mundësohet pershtatja me nevojat e ALBPETROL. Si rezultat i kësaj faze, përdoruesit duhet të jenë të gjendje të hedhin në sistem të dhëna të reja dhe të përdorin konfigurimet dhe reportet standarte.

- **Faza III: Konfigurimi i moduleve në sistem, migrimi i të dhënave**

Në këtë fazë, operatori ekonomik duhet të bëjë pershtatjen e sistemit me nevojat specifike të Albpetrol, duke u bazuar mbi kërkesat e mbledhura përgjatë fazës së parë. Në fund të fazës, sistemi duhet të jetë i gatshëm për operim. Testimet do të kryhen në ambient test të ndërtuar për këtë qëllim. Skenare të testimeve duhet të përcaktohen në fazën e parë dhe të përfshihen në *raportin fillestar*. Sistemi në këtë fazë, duhet të integrohet me sistemin email të ALBPETROL dhe të jetë gatshëm për përdorim.

Gjatë kësaj faze duhet të kryhet edhe migrimi i të dhënave fillestare për popullimin e sistemit.

- **Faza IV: Trajnimi i përdoruesve, venia në punë.**

Operatori ekonomik duhet të realizojë trajnimin e përdoruesve, të përgatisë materialet udhëzuese, dhe mbi të gjitha të perqendrohet në pershtatjen e biznesit me sistemin e ri. Duhet të përgatiten materialet e trajnimit të punonjësve. Këto materiale duhet të publikohen në portalet e brendshme në sistem.

Afati kohor i implementimit të projektit

Zbatimi i sistemit të administrimit burimeve në platformen mix Cloud dhe ne server ate Albpetrol, duhet të kalojë në hapat e mëposhtëm dhe te zgjase jo më shumë se 4 muaj:

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5		M40
1	Faza Përgatitore Raporti fillestar	X						
2	Zbatimi i sistemit te perditesuar me te gjithë modulet Instalimi i sistemit ne te dy ambjentet cloud dhe ne server lokale;	X						
3	Konfigurimi i moduleve ne sistem, migrimi i te dhenave Konfigurimi i te gjithë moduleve, testimi i funksioneve, migrimi i te dhenave dhe pregatitja e manualeve	X	X	X	X			
4	Trajnimi i përdoruesve				X			
5	Fillimi i përdorimit të sistemit,					X	X	X

Testimi i sistemit

Plani i testimit duhet të përmbajë skenarë të detajuar testimi, si edhe të përcaktojë testuesit, aktivitetin e testimit, kriteret e pranimit dhe marrjes në dorëzim. Plani i testimit duhet të nisë e të zhvillohet paralelisht me implementimin e moduleve të ndryshëm.

Ne menyre te vecante do te duhet te testohet secili modul, ne formate te dhenash dhe ne skenare te ndryshem. Përdoruesit e sistemit gjate testimeve do te jene personel i ALBPETROL, dhe operatorit ekonomik.

Regjistrimi i të dhënave

Per secilin modul do të jetë e nevojshme të regjistrohen të dhënat e celjes. Operatori ekonomik, së bashku me stafin që ndjek projektin, do të përcaktojnë datën e celjes së sistemit dhe do të bëjnë të mundur fillimin e punës për regjistrimin e të dhënave. Te dhenat qe nuk ekzistojne ne format elektronik standardizuar do te hidhen direkt ne sistem nga punonjesit perkates.

Trajnim stafi

Operatori ekonomik ka për detyrë të identifikojë nevojat për trajnim dhe të mundësojë materialet e nevojshme për trajnimin e përdoruesve. Ai duhet të organizojë trajnimet për stafin menaxherial, përdoruesit e sistemit dhe për administratorët teknik te sistemit. Në fund duhet të dorëzohen të gjitha materialet e trajnimit.

Suporti përgjatë periudhës fillestare të sistemit

Gjatë periudhës fillestare të përdorimit të sistemit duhet të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për përdoruesit e sistemit.

KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Sistemet do të ruajnë ndërveprimet aktuale, por nëse do të ketë nevojë për ndërveprime të tjera pas zhvillimeve të kërkuara, operatori ekonomik fitues duhet t'i realizojë brenda kësaj procedure. Në mënyrë të vecantë, sistemi duhet të komunikojë me sistemet:

- Email për njoftime të ndryshme që lidhen me sistemin
- Marrja e të dhënave të list prezences nga sistemi i kontrolli të hyrjeve.

RAPORTIMI

Kërkesat e Raportimit. Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në origjinal dhe në 2 (dy) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumit 12 faqesh duhet të prodhohet brenda 1 (një) muaji nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura si dhe kryen detajimin e programit të punës apo të vizitave/udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbëhet prej 20 (njëzet) faqesh (teksti kryesor, duke përfshiruar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit final është 5 (pesë) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi Sistemin. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Raporti i përmendur mësipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Cdo e drejtë mbi kodin burim apo çdo dokumentacion që ka të bëjë **me përmirësimet e zhvilluara në kuadër të kësaj kontrate**, duhet t'i kalojë Autoritetit Kontraktor/përfituesit në format elektronik dhe në letër.

SHËRBIMET E KËRKUARA TË SUPORTIT, SLA

Nivelet e Shërbimit dhe Procesi

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë, për të gjitha sistemet e përfshira në kontratë.

Suporti i Nivelit të Parë

(a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha sistemet e listuara në tabelën e Inventarit të Sistemit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese.

(b)Shërbime Riparimi

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor të operimit të ALBPETROL, në kohëzgjatjen 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar i ALBPETROL ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin “Alarm Madhor” do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i ALBPETROL dhe të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin “Alarmeve Madhore”, duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

(i) **Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.** ALBPETROL do të njoftojë Kompaninë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje Web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga Kompania me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Kompania duhet të kontaktojë ALBPETROL-in dhe të konfirmojë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i AK-së. Në momentin e njohjes së thirrjes nga Kompania, ALBPETROL do të vërë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga Kompania, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostifikimit të problemit të raportuar. ALBPETROL do të koepërojë me kërkesën e Kompanisë për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

(ii) **Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.** Nëse kompania nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të vendos një Teknik Shërbimi në kontakt të dedikuar me ALBPETROL brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga ALBPETROL dhe do t'i jepet akses në sistemet e mbuluara pa çënuar sigurinë e të dhënave, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostifikimit dhe riparimit.

(iii) **Veprimtaritë e Diagnostifikimit dhe Riparimit.** Tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostifikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”, (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Kompania të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Kompania arrin në konkluzion që diagnostikimi ose korrigtimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në zëvendësimin e ndonjë paisje lidhëse nga ALBPETROL ose marrjen e rekomandimeve nga Suporti i Nivelit të Dytë.

Suporti i Nivelit të Dytë

Në rast se kompania nuk arrin dot të zgjidhë Alarmin Madhor dhe pas veprimtarive të përshkruara më lart, atëherë ajo duhet të eskalojë problemin tek prodhuesit e komponentëve të sistemit

Teknikët e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesit dhe të mundësojnë zgjidhjen e çdo problemi në afatet kohore minimale. Kompania duhet të ketë punonjës të certifikuar në përputhje me kërkesat specifike të paraqitura më poshtë në këtë dokument **për secilën nga teknologjitë e mësipërme.**

Ata duhet të hapin ceshtjet tek këta prodhues, përshkruajnë problemin teknik që ka shkaktuar alarmin madhor, konsultohen së bashku për të gjetur zgjidhjen e problemit, marrë prej prodhuesve planin e veprimeve dhe rekomandimet për zgjidhje si dhe zbatimin e masave me përpikmëri sipas këtyre rekomandimeve.

Kompania do të paraqesë në ofertë autorizimet e prodhuesve për të demonstruar se ka mbuluar me saktësi të gjithë komponentët e sistemit me suport të Nivelit të Dytë. Të gjitha këto produkte duhet të kenë jetëgjatësinë sipas përcaktimeve në këtë dokument.

Specifikimet teknike për shërbimin e Mirëmbajtjes të Sistemit

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit janë si më poshtë:

1. Monitorim periodik dhe të rregullt të roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit. Kompania duhet të ndërmarrë veprime proaktive dhe raportuese në rast të:
 - Ezaurimit të resurseve
 - Mos funksionimit të shërbimeve të instaluar në rolet përkatëse
 - Rritjes së madhësisë së logeve në masën që ndikojnë në performancën e sistemit
 - Performancës dhe disponueshmërisë së ulët të sistemit
2. Verifikimi i i backup automatik të sistemeve.
3. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastrukturës.
4. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t'u aprovuar. kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
5. Kompania duhet të kryejë kontroll periodik javor preventivues, monitores në amjentin cloud te ALBPETROL ose me hyrje "remote të sigurt nëpërmjet VPN".
6. Kompania duhet të ofrojë suport 24x7 (për probleme kritike, dhe gjatë orarit zyrtar për probleme të tjera) për sistemin financiar duke filluar nga momenti i fillimit të operimit te sistemit, deri në përfundim të kontratës.
7. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollet e detyrueshme parandaluese dhe preventivuese, si edhe të përshkruajë dinamikat dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.

Shërbimet e Përmirësimit apo modifikimit në Modulet

Kompania fituese duhet të kryejë përmirësime apo modifikime software-i që përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

1. Azhornimin, përmirësimin dhe modifikimin e sistemit
2. Hostimin e të gjithë sistemeve (kjo nëpërmjet shërbimeve cloud të mbrojtura, nga prodhuesit e sistemeve);
3. Pastrimin dhe konvertimin e të dhënave;
4. Përmirësimi i performancës së proceseve aktuale të sistemeve të përfshira në këtë kontratë;
5. Përmirësimi i raporteve aktuale që prodhohen nga sistemet e përfshira në këtë kontratë sipas kërkesave të institucionit.

Azhornimi, përmirësimi apo modifikimi i sistemit do të bëhet për modulet dhe versionet ekzistuese të përshkruara si komponentë të sistemit. Modifikimet mund të lindin si pasojë e ndryshimeve ligjore ose kërkesave për përmirësime nga përdoruesit etj.

Është i domosdoshëm dokumentimi para dhe pas ndërhyrjeve në sistem.

Shërbime periodike dhe monitorimi i shërbimeve

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me ALBPETROL një axhendë periodike kontrollesh si më poshte. Funksionet e mëposhtme në kushtet e sistemeve Cloud, realizohen në bashkëpunim midis Operatorit Ekonomik dhe Prodhuesit të sistemit:

1. Ditore
 - Monitorimi i statusit të shërbimeve nëpërmjet agjentëve (software monitorimi)

-
- Ndërmarrje e aksioneve specifike në rast problemesh të vërejtura.
2. Javore
 - Kontroll i logeve të serverave
 - Të kryejë mirëmbajtje proaktive, nese rekomandohet nga prodhuesi.
 3. Mujore.
 - Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit
 - Kontroll i log-eve software
 - Përditësim i aplikacioneve në serverat nese ka perditësime, etj.
 - Rishikim i të dhënave mbi performancën e serverave
 4. Përgatitja e raporteve mujore dhe tre mujore mbi problemet, statusin dhe ecurinë e zgjidhjes së tyre, për shërbimet e përfshira në këtë kontratë.

Shërbime të konsulencës

Përgjatë shërbimit të mirëmbajtjes, Kompania duhet të ofrojë gjithashtu shërbimet e mëposhtme të konsulencës.

1. Asistencë për stafin teknik të ALBPETROL në analizën e të dhënave;
2. Asistencë teknike për problemet e lidhura me komunikimin me sisteme apo komponente të infrastrukturës.
3. Dokumentimi i vlerësimit të nevojave, kërkesave të përdoruesit dhe përgatitja e draftit të specifikimeve teknike për ndryshimet që janë pasojë e ndryshimeve ligjore dhe që prekin shërbimet elektronike të përfshira në këtë kontratë.

Trajnimi i personelit teknik:

Kompania fituese duhet të ofrojë në vazhdimësi, shërbime të trajnimit që lidhen me ndryshimet teknologjike të realizuara në sistem apo me ndryshime në strukturën organizative të personelit të ALBPETROL. Trajnimi do të organizohet në klasa të përbëra me 5 punonjës. Këto trajnime duhet të planifikohen të realizohen si trajnime formale me materiale të vecanta trajnimi në formë letër dhe elektronike të përgatitura për këtë qëllim; konfigurimin e kompjuterave që do të shërbejnë për demonstrimin si dhe me një proces formal të vlerësimit të rezultateve pas trajnimit. Për nevojën e përgatitjes së ofertës teknike financiare, kompania duhet të paraqesë së bashku me ofertën teknike metodologjinë e zhvillimit dhe të ndjekjes së trajnimeve ndërsa volumi i përgjithshëm i trajnimeve të planifikuara duhet të jenë si në tabelën e cmimeve.

Asistencë në vend për çështjet operationale të sistemit

Përgjatë shërbimit të mirëmbajtjes, Kompania duhet të ofrojë një konsulent të dedikuar për sistemin e administrimit burimeve njerzore. Konsulenti, duhet të jetë i certifikuar nga prodhuesi i sistemit dhe duhet të:

- shërbeje si pikë e parë kontakti për personelin e ALBPETROL. Asistenca kërkohet të ofrohet, jo vetëm për çështje që lidhen me mos operimin apo difektet në sistem, por kryesisht me probleme apo asistencë në operimin e sistemit
- mbajë log për asistencën e dhënë;
- përshkallëzojë brenda personelit tjetër të konsulentit, çështje që lidhen me mos funksionimin e rregullt të sistemit; dhe ndjek në vazhdimësi zgjidhjen në kohë të problematikave teknike;
- raportojë në bazë mujore listën e problematikave kryesore të hasura përgjatë shërbimit të asistencës teknike;

Përgjigja si dhe përshkallëzimi i shërbimit

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre. Sigurimi i disponibilitet i sistemit ne cloud duhet të jetë mbi 99.5%.

Serioziteti 1 (Kritik/ i Lartë)	Serioziteti 2 (I Mesëm)	Serioziteti 3 (I Ulët)
Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		
Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime finaciare të mëdha</i> për përdoruesit ose <i>rrezikon shumë aktivitetin ekonomik</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime finaciare të konsiderueshme</i> për përdoruesit ose <i>rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime financiare minimale</i> për përdoruesit ose <i>rrezikon në mënyrë minimale aktivitetin ekonomik</i> të përdoruesve
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të <i>realizojnë pjesën më të madhe të punës</i> së tyre.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të <i>realizojnë disa pjesë të vogla të punës</i> së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për informacion.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të <i>realizojnë një pjesë të vogël të punës</i> së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër <i>shumë të vogël</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon në <i>1 (nje) ose 2 (dy)</i> përdorues
Zgjidhje alternative e përkohshme [Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2]		
<i>Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund të realizohet në një mënyrë tjetër)</i>	<i>Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</i>	<i>Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</i>
Koha e përgjigjes		
Brenda 30 minutave Paraqitja në dispozicion, jo më shumë se 2 orë.	Brenda 6 (gjashtë) orëve ose ditën tjetër të punës.	Brenda 24 (njëzet e katër) orëve ose ditën tjetër të punës.
Koha e Operimit të Suportit		

24 orë përgjatë 7 ditëve të javës	Gjatë orarit zyrtar	Gjatë orarit zyrtar
-----------------------------------	---------------------	---------------------

MJEDISI I TESTIMIT

Kompania duhet të krijojë / konfigurojë mjedisin e testimit për aplikimin e updateve, fikseve apo përditësimeve në software, përpara instalimit të tyre në serverat *production*. Cdo ndërhyrje në infrastrukturën primare të operimit të sistemeve duhet të kryhet vetëm pas testimit të suksesshëm paraprak të ndryshimeve në ambjentet test.

Kompania duhet të monitorojë update që del nga prodhuesi i Software dhe të propozojë pranë ALBPETROL-it përparësitë e implementimeve të tyre. Ajo duhet të kryejë këto përditësime pasi të jetë rënë dakord dhe pas testimit të mundshëm.

ZËRAT E PUNËS, BUXHETIMI

1	2		3	4
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Afati i implementimit (në muaj)
1	License subscription vjetor i sistemit te Aseteve dhe Inventareve (10 Users), per modulet: • Asetet Fikse; • Inventaret; • Blerjet; • Mirembajtja e paisjeve/aseteve dhe supporti ne vend (field operation) me harte nepermjet paisjeve mobile PDA; • Administrimi i perdoruesve, rolet dhe aksest ne sistem; • Raportimit dhe analizës së tipit BI;	Vit	3	2
2	Hostimi i sistemeve ne amjentin cloud te prodhuesit;	Vite	3	1
3	Sherbimi i perditësimit të sistemit, përfshirë: - Setup te sistemit; - Celja e te dhenave ne sistemin e ri; - Ndertimi i raporteve;	Set	1	4
4	Trajninin e personelit teknik per sistemin e ri	Klasa	3	1
5	Mirëmbajtja dhe support Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshtje teknike dhe operacionale	Muaj	36	36

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Update programi kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe paisja e tyre me barcod

ZËRAT E PUNËS

1	2		3
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia
1	License subscription vjetor i sistemit të Aseteve dhe Inventareve (10 Users), per modulet: • Asetet Fikse; • Inventaret; • Blerjet; • Mirembajtja e paisjeve/aseteve dhe supporti ne vend (field operation) me harte nepermjet paisjeve mobile PDA; • Administrimi i perdoruesve, rolet dhe aksest ne sistem; • Raportimit dhe analizës së tipit BI;	Vit	3
2	Hostimi i sistemeve ne amjentin cloud te prodhuesit;	Vite	3
3	Sherbimi i perditesimit të sistemit, përfshirë: - Setup te sistemit; - Celja e te dhenave ne sistemin e ri; - Ndertimi i raporteve;	Set	1
4	Trajninin e personelit teknik per sistemin e ri	Klasa	3
5	Mirëmbajtja dhe support Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshtje teknike dhe operacionale	Muaj	36

Afatet e ekzekutimit:

Update programi kompjuterik për menaxhimin e magazinave dhe paisja e tyre me barcod për një periudhë 4 muaj dhe tre vjet mirëmbajtje.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Hyrje

Albpetrol, si një prej aktorëve kryesorë në tregtinë e naftës në Shqipëri, me një histori të gjatë dhe të pasur në menaxhimin e burimeve të naftës. Albpetrol sh.a. është shoqëria shtetërore e themeluar më 6 Prill të vitit 1999, dhe që nga themelimi ajo trashëgoi të gjitha asetet dhe vendburimet e naftës në Shqipëri.

Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit ndërsa shoqëria ushtron aktivitetin e saj edhe në qendrat e prodhimit në Fier, Ballsh, Kuçovë, Patos etj. Albpetrol sh.a është në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Situata Aktuale dhe Sfidat

Nisur nga aktiviteti si dhe shtrirja gjeografike e ndërmarrjes duhet thënë paraprakisht se numri, kompleksiteti i aseteve është një sfidë e vecante për Albpetrol. Vec mbajtjes së një regjistri unik qendror të aseteve, sfidë tjetër në këtë fushë është inventarizimi, perditesimi i veprimeve me asetet, mirëmbajtja e tyre si dhe ndjekja në vazhdim i nderhyrjeve përmirësuese.

Vec veprimeve që lidhen me asetet, problematike ditore paraqet edhe mbajtja e librave që lidhen me inventaret e shoqërisë, e në mënyrë të vecante e inventareve që shërbejnë si pjesë këmbimi ose pjesë e konsumueshme e makinerive. Krijimi i kalendarit të nderhyrjeve në asete, planifikimi i atyre parandaluese si dhe korrigjuese është gjithashtu një sfidë për punën e përditshme në këtë fushë.

Duke konsideruar problematiken e mesiperme, përgjatë vitit 2018 u realizua një nderhyje fillestare në këtë fushë dhe është punuar për krijimin e një libri të përbashkët asetesh, i cili synonte në:

- 5) krijimin e një baze të dhënash të aseteve,
- 6) saktësimi i vlerës kontabel për to;
- 7) krijimin e procedurave standarde elektronike në mirëmbajtjen; si dhe
- 8) gjurmimi në paisje PDA të aseteve, ku secili prej tyre do të kishte një kod unik elektronik.

Sistemi, prej kohësh nuk ka një kontratë të mbështetjes teknike dhe të garancisë, është tashmë vjetëruar dhe baza e të dhënave dhe operimi është shumë i pjesshëm. Si rrjedhojë edhe të dhënat nuk janë përditësuar.

Nevoja për përmirësime dhe shtesa të sistemit

Nisur nga gjendja aktuale, si dhe nevoja për përdorimin e gjere të të sigurte të sistemit, ai kërkohej të përditesohej me teknologjinë e fundit në treg në të gjithë komponentet si në ndërfaqen web, bazën e të

dhenave, aplikimit te teknologjive te fundit te shkembimit te te dhenave rest API. Sistemi duhet te jete operativ si brenda rrjetit IT te Albpetrol ashtu edhe nga jashte tij. Ai duhet te aksesohet ne cdo kohe dhe ne cdo vend prej ekipeve te mirembajtjes dhe te inventarizimeve ne te gjithë territorin. Per te garantuar sigurine disponueshmerine e te dhenave, sistemi kerkohet te jete i pershtatshem per cloud si dhe backup te informacionit te kryhet ne cdo kohe ne serverat fizike te rrjetit te brendshem te Albpetrol.

Ne menyre te vecante kerkohet qe sistemi te jete plotesisht i sigurte ne akses, dhe te dhenat te ruhen ne dy ambiente te ndara nga njeri tjetri,

Per te ofruar nje shkalle te larte te sigurise, kerkohet qe sistemi dhe te dhenat te mundet te ruhen njekohesisht ne dy vendndodhje, nje ne server te Albpetrol dhe ne servera cloud te prodhuesit te sistemit. Aksesit ne sistemin cloud te prodhuesit duhet te aksesohet vetem nga Albpetrol, dhe vete ofertuesi i sistemit te jete pergjegjes per te gjitha ceshtjet e sigurise qe lidhen me aksesin, sherbime te perditimit si dhe mbrojtjen nga sulmet. Perditimi me versionet e fundit te OS, DB si dhe aplikimit kerkohet te kryhet ne menyre automatike, nga prodhuesi.

Vec perditimit automatik te teknologjise, kerkohet qe sistemi te pasurohet me mjetet e fundit qe jane sot ne treg si:

- aksesit online i sigurte i sistemit, brenda dhe jashte institucionit;
- planifikimi i sherbimit te mirembajtjes;
- perdorimi i versionit mobile dhe PDA per akses ne cdo kohe nga skuadrat e mirembajtjes ne terren; keshtu qe komunikimet e detyrave si dhe plotesimi i raporteve te mirembajtjes dhe nderhyrjeve te jene plotesisht te aksesueshme ne paisje mobile, PDA, Ipad etj.
- plotesimi i te dhenave te aseteve me vendndodhjen gjeografike si dhe paraqitja e planit te nderhyrjes ne formen e nje rruge/rrjedhe levizjesh ne harte;
- shtimi i funksioneve te raportimit
- krijimi e nje regjistrimi te blerjeve te paisjeve dhe te inventareve;
- percaktimi i vendndodhjeve ne magazine per cdo element te inventarit;
- administrimi i inventareve si dhe urdherave te levizjes se tyre direkt nga PDA
- krijimi i mundesive per ruajtjen e kartelave teknike ne formen e manualeve teknike ne nje arkive elektronike dokumentare;
- kriimi i nje sistemi analize dhe raportimi qe do te marre dhe perpunoje te dhena e kryeje analiza nga te gjithë modulet ne sistem;

Me konkretisht nje liste e funksioneve te tjera, qe kerkohet te zbatohen, jane si meposhte:

- 6) Zbatimi i nje sistemi administrimit te brigadave te mirembajtjes te tipit (field operation) i cili te jete plotesisht mobile;
- 7) Lidhja e sistemit te mesiperme me sistemin e raportimit te difekteve dhe nevojave per nderhyrje, qe do te mundesonte njoftimin e brigadave te mirembajtjes ne kohe reale per nevojat per nderhyrje dhe asistence teknike;
- 8) Administrimi i inventareve me vendndodhje fizike brenda magazines, si dhe automatizimi i veprimeve ne magazine me paisje PDA dhe Barcode.
- 9) Ruajtja e dokumentave personale te aseteve ne dosjen teknike perkatese;
- 10) Zbatimi i nje sistemi raportimi dhe analize me te dhena nga te gjithë modulet;

Per kete, qellimi i projektit percaktohet si perditimi i sistemit ne cloud, arrijta e nje shkalle te larte sigurie te operimit si dhe shtimi i funksioneve qe lidhen me administrimin e mjeteve.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i kontrates është permiresimi i sistemeve ekzistuese, forcimi i sigurise se sistemeve si dhe zgjerimi i saj me funksione te reja.

Rritja e shkalles se sigurise mendohet te kryhet nepermjet:

- Krijimit te nje versioni te sigurte, perditesuar te bazes se te dhenave, te aplikimit, sistemit te operimit;
- Hostimit te sistemit ne cloud dhe ne serverat e brendshem te Albpetrol, dhe rrjedhimisht ruajtja e te dhenave ne dy vende;
- Operimit te sistemeve te mbrojtjes se sistemit cloud direkt nga prodhuesi, duke aplikuar mjetet e fundit te sigurise kibernetike;
- Ndertimi i profileve te avancuara te kontrollit te aksesit te perdoruesve duke perfshire kufizime ne nivel:
 - funksionesh ne sistem,
 - strukturash organizative te Albpetrol, si dhe
 - *dataset* (grup te dhenash specifike).

Ndersa funksione kryesore shtese do te jene:

- Administrimi dhe planifikimi i nderhyrjeve ne terren ne aseteve, direkt nga sistemi dhe me akses online kudo dhe ne cdo kohe;
- Administrimi i magazinave me vendndodhje fizike, si dhe automatizimi i veprimeve me paisje PDA.
- Zbatimi i nje moduli te vecante per administrimin e blerjeve, i lidhur direkt me moduln e inventarit per perditesimin ne kohe reale te planifikimit te mjeteve te kembimit ose te konsumit mbi asetet;
- Zbatimi i nje sistemi raportimi dhe analizes me te dhena nga te gjithë modulet;

Siguria

Sistemi kerkohet shkalle te larte sigurie:

- Siguria e të Dhënave: Masa të forta të sigurisë për të mbrojtur të dhënat teknike dhe te operimit te mjeteve;
- Identifikimi i sigurte i perdoruesve ne sistem, nepermjet aplikimit te metodologjise se identifikimit te shumfishte (MFA, *Multifactor-Authentication*);
- Përshtatshmëria me Rregulloret Ligjore, Sigurimi që të gjithë proceset janë në përputhje me rregulloret per administrimin e aseteve/mjeteve, standardet fiskale si dhe nevojave te vecanta per kontrollet teknike dhe sigurimin e mjeteve te transportit.

Per evitimin e rreziqeve qe lidhen me sisteme te reja IT, sigurine e aksesit si dhe te te dhenave kerkohet qe sistemi i permiresuar te ruhet ne dy vende te sigurta lokal ne ambjentin e serverave virtual te Albpetrol si dhe *Cloud* ku te mbrohet nga prodhuesi me mjete te avancuara. Per me shume, ky sistem duhet te perditesohet periodikisht cdo muaj nga vete prodhuesi. Perditesimi duhet te perfshije te gjithë elementet qe lidhen me sistemin e operimit, bazen e te dhenave, ambjentin e aplikimit si dhe funksione te reja te periudhes.

Aplikimit te sistemit *cloud* kerkohet qe shkalla e operimit te sistemit te jene e nje shkalle te larte, mbi 99.8% dhe e pavarur nga siguria, interneti apo gatishmeria e infrastruktures se brendshme te ALBPETROL.

Qëllimi i kësaj kontrate shërbimi,

- **Instalimi i sistemit te permiresuar.** Ky sistem do te duhet te instalohet ne 2 ambjente, server dhe Alpetrol si dhe cloud te prodhuesit. Sistemet duhet te shkembejne te dhena ne menyre automatike dhe te garantojne shkalle te larte te sigurise se te dhenave, thuaj 100%. Instalimi duhet te kryhet mbi versione te reja te gjithë elementeve te aplikimit. Ne procesin e instalimit duhet te kryhen te gjithë parametrizimet dhe lokalizimet e nevojeshme.

- **Pershtatja e proceseve te albpetrol dhe migrimin e te dhenave.** Pas instalimit, sistemi duhet te parametrizohet sipas nevojave te Albpetrol dhe me pas kerkohet te kryhen migrimi i te dhenave. Te dhenat do te jepen nga Albpetrol dhe kerkohet qe ato te konfirmohen nga grupi i punes si perpara ashtu edhe pas migrimit. Cdo funksion i ri apo ekzistues duhet me pas te kaloj nje proces verifikimi dhe kontrolli per te konfirmuar perputhshmerine me nevojat e Albpetrol.
- **Operimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit.** Pas zbatimit të sistemit kërkohej mbështetje teknike mbi sistemin/modulet. Per instalime prane Albpetrol, mirembajtja dhe monitorimi i operacioneve te ruajtes si dhe siguria e aksesit ne rrjet do te kryhet nga personeli Teknik i Albpetrol.
- **Hostimi, backup ne infrastrukturën mix cloud dhe ne vend.** Te dhenat dhe sistemet duhet të ruhen në dy ambjente ne cloud dhe ne server te Albpetrol. Operatori ekonomik veç hostimit duhet të sigurohet edhe për komponentët e tjerë që lidhen me sigurinë, backup si dhe lidhjen internet të sigurtë. Ambientet cloud të operimit te sistemeve si dhe ato te backup duhet të jenë brenda EU's.
- **Trajnimi i personelit të ALBPETROL.** Krahas shërbimeve të mësipërme, shërbimi kërkohej të përfshijë edhe çështje të rëndësishme që lidhen me trajnimin e vazhdueshëm të personelit. Per kete, vec trajnimit si pjese e zbatimeve dhe sherbimeve fillestare kerkohet qe minimalisht 1 here ne vit, te kryhet trajnim perditues i personelit te Albpetrol.

OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është përmirësimi i sistemit te administrimit te mjeteve me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës në të gjithë komponentet dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem. Sistemi duhet të mbështetet në teknologji modern, te versionit te fundit e paisur me shkalle te larte automatizimi (lidhje midis moduleve) si dhe raportimi inteligjent, duke minimizuar nevojën per burime te brendshme dhe minimizuar gabimet qe shoqerojne aktivitetin manual.

Komponentët kryesorë të sistemit, të cilët janë edhe objekt direkt i këtij shërbimi janë:

- I. **Moduli per administrimin e porosive apo urdher blerjeve** duhet te realizoje hedhjen ne sistem te gjitha porosive per blerje te aseteve ose te inventareve. Ky duhet te komunikojë ne menyre te drejteperdrejte me modulën e inventareve dhe duhet te shkembej info: Per cdo inventar ne sasine minimale duhet te krijojë nje kerkese per blerje; dhe per cdo urdher blerje te inventareve duhet te perditetojë sasine me nje kollone te vecante ku te pasqyrojë sasine ne pritje (porosi), se bashku me kohen e perafert te mberritjeve te artikujve ne porosi.
- J. **Moduli për menaxhimin e aseteve,** qe sherben per ruajtjen e te dhenave teknike dhe financiare per aseteve. Sistemi duhet ne menyre te vecante, te evidentojë te gjitha veniet ne pune ose daljet nga perdorimi, transferimin midis vendndodhjeve, personave apo njesive qe operojne apo administrojne mjetet; Ky modul duhet te realizojë gjithashtu edhe ruajtjen vlerave te assetit si dhe procedurave kontabel qe lidhen me amortizimin, vleresimin apo rivleresimin pozitiv ose negative te vleres kontabel;
- K. **Moduli për administrimin e inventareve** administron proceset qe lidhen me administrimin e magazinave, vendndodhjeve apo rafteve ne sistem. Moduli duhet te mundesojë regjistrimin e te dhenave per artikuj dhe kategorine e tyre. Moduli duhet te mundesojë proceset qe kane te bejne me hyrje/daljet, transferimin midis vendndodhjeve. Levizjet ne magazine te mundesohen plotesisht nepemjet paisjeve PDA. Moduli duhet te mundesojë edhe ndjekjen e sasive minimale ne baze te magazines si dhe krijimin automatik te urdher transferimeve ose te blerjeve nese e nevojeshme per plotesimin e sasise minimale. Moduli duhet te jete plotesisht i integruar me ate te mirembajtjes se paisjeve (aseteve) per regjistrimin e flete daljeve ne rastet e perdorimit per ceshtje te mirembajtjes.
- L. **Moduli per administrimin e sherbimeve te mirembajtjes** duhet te mundesojë ruajtjen e sherbimeve te mirembajtjes parandaluese ose riparuese per cdo asset. Cdo nderhyrje kerkohet te permbaje brenda vetes edhe artikuj ose inventaret e konsumuar, sebashku me vlerën e inventareve apo sherbimeve.
- M. **Moduli per administrimin e nderhyrjes ne vend (field operation)** duhet te mundesojë ruajtjen dhe sherndarjen e urdherave te punes pergjate mirembajtjes ne vend te aseteve. Keto urdhera duhet te sherndahen automatikisht per brigadat e mirembajtjes. Sistemi duhet te jete i asesueshem ne paisje PDA ose mobile dhe brigadat kerkohet te njoftohen automatikisht. Sistemi duhet te ofrojë

mundesine e ruajtjes se vendodhjeve te asetit ose te vendodhjes ku kerkohet nderhyrje/asistence. Cdo vendndodhje duhet te demonstrohet ne harte, per te lehtesuar gjendjet e asesit. Cdo nderhyrje duhet e pasqyrohet ne sistem direkt nga paisje mobile/pda. Dokumentimi duhet te lejoje hedhjen e artikujve ose inventaret e konsumuar, sebashku me vleren e inventareve apo sherbimeve si dhe konfirmimin nga kerkuesi i sherbimit.

- N. **Modulin e arkives se dokumentave teknike**, mundeson ruajtjen ne forme elektronike te dokumentacionit te mjeteve. Cdo dokument, mundet te percaktohen te drejtat per perdorues/rol qe ka te drejte. Sistemi duhet te kryej njoftime per ndryshim te drejtave apo per perditese ne dosje teknike te assetit.
- O. **Moduli i raportimit dhe i analizes**, mundeson raportimin ne kohe reale te te dhenave, dergimin e raporteve ne rruge elektronike dhe mundeson menyra te ndryshme te raportimi si ajo tabelare, grafike, dashboard, etj.. Ne menyre te vecante analizat dhe reported me te dhena nga i gjithe sistemi duhet te mundesohet ne ne forme raportesh PDF dhe ne format te editueshem excel, csv, etj. ku perdoruesi do te mundet te kryej analiza shtese.
- P. **Moduli i administrimit te ceshtjeve** (Trouble Ticket System) duhet te mundesoje mbledhjen e kerkesave per nderhyrje qe kryhen direkt nga perdoruesit e mjeteve (aseteve). Moduli duhet te perfshije edhe procesin e monitorimit dhe te ndjekjes se ecurise se nderhyrjes riparuese. Ndjekje e kohes se nderhyrjeve dhe e afateve te pergjigjes (se brigades e mirembajtjes) duhet te percaktohet prioriteti i ceshtjes.

Regjistrimi i fillestar i te dhenave ne sistem do te realizohet ne dy menyra:

- Marrja prej sistemeve ekzistuese; ose
- Marrje nga burime te tjera informacioni qe gjenden prane Albpetrol.

Ne cdo rast, ky proces duhet te realizohet me angazhimin e grupit te punes se Albpetrol, i cili do te:

- Konfirmoje burimin e te dhenave;
- Versionin paraprak te dhenave (perpara migrimit);

si dhe, ne perfundim te migrimit:

- do te konfirmoje sakesine.

Procesi i migrimit i te dhenave do te kryhen nga operatori ekonomik. Ndersa te dhena qe nuk ekzistojne, ose cilesia e informacionit aktual nuk eshte e larte, do te duhet te hidhen ne menyre manuale prej perdoruesve qe mbulojne funksionet, prane Albpetrol.

Në kuadrin e zbatimit te projektit, ofertuesi ekonomik duhet të realizojë:

- Analizën e gjendjes aktuale;
- Hartimi i një dokumenti përshkrues të sistemit, ndryshimeve per cdo modul (vecanerisht ato te reja);
- Implementimin e moduleve ose te ndryshimeve, migrimin e te dhenave.
- Trajnimet për të gjithë stafin që do të përdori këtë sistem (të ndara për përdoruesit e sistemit dhe administratoreve të sistemit);

Modulet e mësipërme duhet të jenë të integruara me njëra tjetrën dhe standartizojnë dhe automatizojnë procedurat e administrimit te burimeve njrezore të ALBPETROL. Integrimi midis moduleve sjell evitim te hedhjes se dyfishte te te dhenave, dhe mundeson kontrollin e infromacionit te dy ose me shume drejtime (module).

SUPOZIMET DHE RISQET

Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti do të bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti
- Bashkëpunimi midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit
- Vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e projektit
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshëm për implementimin e këtij projekti
- Përcaktimi i saktë i buxhetit të nevojshëm për realizimin me sukses të projektit

Risqet

Është i rëndësishëm impenjimi i plotë i grupeve të punës pjesëmarrëse (nga të dyja palët) në zhvillimin e projektit. Disa nga faktorët që do të mund të riskonin ecurinë e projektit:

- Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve kyç dhe grupeve të interesit mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të projektit
- Vlerësimi jo i saktë i situatës aktuale të sistemit dhe infrastrukturës
- Mospërcaktimi i saktë i burimeve të nevojshëm për realizimin e projektit
- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e moskoordinimit të punës mes pjesëtarëve të përfshirë në këtë proces
- Mungesa e bashkëpunimit me palët e treta për vënien në dispozicion të të dhënave dhe *web service*-ve përkatëse.
- Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik në të tilla projekte.

MBULIMI TEKNIK

Ky shërbim duhet të përfshijë (në përputhje me këto Terma Reference) në mënyrë të domosdoshme:

- Mirëmbajtjen e programeve bazë;
- Zbatimin e moduleve shtese;
- Migrimin dhe hostimin e moduleve të sistemit në cloud tek infrastruktura e sigurve cloud e prodhuesit të sistemeve; Instalimi i moduleve të perditesuara ne serverat e Albpetrol si dhe mundësimi i shkëmbimit të dhenave midis dy instalimeve të ndryshme.
- Përditesimin falas të sistemeve nëpërmjet patches, në varësi të nevojave të ALPETROL si dhe të nevojave për përditësim, nga vetë prodhuesit e programeve aplikative. Përditësimi i sistemit duhet të kryhet në mënyrë të automatizuar dhe pa ndërhyrjen e përdoruesve të sistemit. Në mënyrë të vecantë përditësimet duhet të kryhen edhe lidhur me patchet apo instalimet e nevojshme që dalin si nevojë e rritjes së sigurtisë së sistemeve.
- Trajnimin e personelit për sistemet
- Konsulencë në çështje që lidhen me procedurat e përdorimit të sistemi, si dhe përputhja me kërkesat specifike të ALBPETROL,

KOMPONENTËT KRYESORË TË SISTEMIT

Sistemi duhet t'u krijojë mundësi përdoruesve të regjistrojnë të gjitha aktivitetet e tyre periodike (ditore, javore, mujore etj) të veprimeve që kanë të bëjnë me aktivitetin e administrimit të burimeve njerëzore.

Modulet kryesore në sistem

Modulet kryesore, përbërëse të sistemit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi
1	Moduli: Blerjet
2	Moduli: Asetet/Mjetet

3	Moduli: Inventaret
4	Moduli: Administrimit i shërbimit të mirembajtjes
5	Moduli: Administrimin e nderhyrjes në vend (field operation)
6	Moduli: Raportimit dhe analizës së tipit BI
7	Moduli: Arkives së Dokumentave teknike të Aseteve
8	Moduli: Administrimit të ceshtjeve (<i>Trouble Ticket System</i>)

Funksionet dhe lidhjet kryesore midis sistemeve

Më poshtë përshkruhen funksionet kryesore, në sistem.

(a) Specifikimet Teknike

Sistemi i administrimit të mjeteve duhet të mundësojë krijimin e një baze të dhënash të përqendruar të asetëve, inventareve si dhe operacioneve që lidhen me to. Ky sistem duhet të jetë një zgjidhje e gjerë, e plotë dhe të mundësojë mbështetje për kompani globale të tipeve të ndryshme të industrisë. Sistemi duhet të mbështetet në teknologji modern, shkallë e lartë automatizimi, sistem të avancuar të raportimit inteligjent.

Te përgjithshme

- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një zgjidhje cila të mbështetet plotësisht në arkitekturë WEB dhe të jetë e pavarur nga platforma e sistemit operativ.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një zgjidhje që sistemi të jetë i bazuar në platformën WEB, me mundësi aksesimi nga çdo klient windows, Linux, Apple, Android etj.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një zgjidhje në të cilën duhet të mbështetet dhe të jetë i hapur për teknologjinë e shërbimeve WEB (WEB Services).
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë një mjet për integrimin me sisteme të tjera duke përdorur teknologji të avancuara *Rest API* nepermjet shkëmbimit të informacionit në formate XML, Json, etj.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë në sistem që të jetë në gjendje të menaxhojë në rrugë informatike politikat/te drejtat dhe proceset e punës së stafit në përputhje me pozicionet e punës.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të ketë ndërfaqe në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të jetë i bazuar në një sistem operimi open source (Linux, Unix, etj.).
- Sistemi duhet të jete i ndertuar për të operuar në cloud, si dhe të lejoje instalimin në serverat lokale të Albpetrol. Sistemi duhet ofrojë mundësinë e shkëmbimit të dhënave nga cloud në sistemet lokale dhe anasjelltas.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që baza e të dhënave për sistemin të jetë i bazuar në platforme open Source. Platforma që do menaxhojë dhe do mundësojë bazën e të dhënave nuk duhet të kërkojë licensë të specifikuar për funksionimin dhe mbarëvajtjen e tij.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që platforma e menaxhimit të bazave të të dhënave (databaza) e përdorur nga sistemi duhet të jetë ndërtuar në sistem Cluster për të mundësuar qëndrueshmëri të lartë në çdo kohë, si dhe të ofrojë operimin në cloud dhe në instalime në vend (on-premise).
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi duhet të ketë mundësi që të instalohet në sisteme ekzistuese virtuale të Albpetrol.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të instalohet dhe të jete i aksesueshem brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së kontratës. Sistemi duhet të ketë funksionet baze si aksesimi dhe navigimi në aplikacion, menaxhimin e userave etj.
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë që sistemi të sigurojë të gjitha shërbimet e moduleve të sipërpërmendura, brenda 4 muajve nga data e lidhjes së kontratës.

- Sistemi duhet te mundesoje akses ne vartesi te pozicionit dhe rolit te perdoruesve
- Sistemi duhet te mundesoje login e unifikuar ne te gjitha funksionet (SSO - Single Sign ON);
- Sistemi duhet te jete i aksesueshem nga cdo paisje, perfshire edhe ato mobile;
- Sistemi duhet te ofroje version mobile app per instalim ne aparatet mobile te punonjesve.
- Profilet e perdoruesve si dhe shkalla e aksesit ne sistem, duhet te jene te modifikueshme (prsh punonjes, drejtues, burime njerzore)
- Sistemi duhet te mundesoje krijime te pakufizuar punonjesve, ne menyre te vecante te lejoj grupimin sipas njesive organizative.
- Sistemi duhet te mundesone percaktimin e njoftimeve, te detyrave apo te funksioneve ne nje perdorues ne sistem, ose ne nje grup perdoruesish.
- Sistemi duhet te mundesoje kerkimin e pergjithshem (fuzzy) ne baze te te cilit, ne cdo hedhje per search sistemi duhet te kthej jo vetem te dhenat qe plotesojne plotesisht kriterin e kerkimit por edhe ato te cilat 'i perafrohen' tekstit ne kerkim.
- Sistemi duhet te ofroje mjete per ndertimin (dhe modifikimin) e workflow qe lidhet me proceset e brendshme. Keto ndryshime mundet te jete si ne hapa ashtu edhe ne personat, rolet apo njesite pergjegjes per secilin nga hapat.
- Sistemi duhet te mundesoje kerkim (search) jo vetem ne te dhena baze te strukturuara por edhe ne dokumentat e lidhur attached qe jane ne formarin PDF.
- Sistemi duhet te lejoj perdoruesit te perdorin programe per editimin tekst, ruajtjen e dokumentave te skanuar apo digital ne forme PDF, word, Excel, Imazhe etj. Ne varesi te drejtave perdoruesit, duhet te lejojne te kryejne ndryshime, permiresime, shtim versioni ose ndryshim kategorizimi te dokumentit.
- Sistemi duhet te jete i hapur per aplikimin e teknologjive te inteligjences artificiale, ne rekomandimin e veprimeve qe lidhen me burime njerzore.
- Sistemi duhet te ofroje mjete per njoftimin e perdoruesve per ngjarje kryesore ne sistem, sikurse mundet te jene datat e mbylljes se procedurave, data qe lidhen me kthimin e pergjigjeve te kerkesave, realizimin e vleresime periodike, etj.
- Sistemi duhet te mundesoje funksione qe lidhen me kerkimin e avancuar, si dhe ruajtjen e kerkimeve apo kriterave te kerkimit per kerkimet e mevonshme.
- Sistemi duhet te ofroje dashboard te perbashket per te gjitha perdoruesit. Ne to mundet te publikohen ngjarjet kryesore ne sistem sikurse jane perditesimet ne strukture, punonjesit, vleresimet, planifikimet e turneve, prezenca ne pune si dhe procedurat e tjera.
- Sistemi duhet te mundesoje tutoriale ne web qe lidhen me perdorimin e sistemit.
- Sistemi duhet te mundesoje mjete per marrjen e pershtypjeve te perdoruesve si dhe mesazherise per komunikime te brendshme (perfshire edhe pjesmarresve ne sistem);

Qendrueshmeria

- Sistemi duhet te ofroje qendrueshmeri, shkalle te larte operimi dhe sigurie te larte.
- Sistemi duhet te plotesoje standardet nderkombetare te ruajtjes se te dhenave personale;
- Sistemi duhet te ruaj integritetin dhe gjurminin ne cdo infomacion te hedhur ne te;
- Cdo ngjarje dhe regjistrim ne sistem, duhet te regjistrohet. Bashke me kete, sistemi duhet te ruaje perdoruesin, daten oren si dhe vendim ne te cilin u krye ndryshimi.
- Sistemi duhet te jete i hapur per shkembime te informacionit me sisteme te tjere te jashtem, sikurse ai i kontrollit te hyrjeve, email, rrjete sociale per publikime te mundeshme te vendeve vakante, etj.

(a) Kërkesa të përgjithshme

Sistemi i kërkohet të jetë një paketë e gatshme dhe plotësisht e integruar me të gjitha modulet e tjera të përfshira në project. Ai duhet te jete i hapur për integrame me paketa apo aplikime të tjera të administrimit të operacioneve që ALBPETROL.

Në këtë drejtim, ky sistem kërkohet të përfshijë modulet/nënsistemet e mëposhtme:

Nr	Përshkrimi
1	Moduli: Blerjet
2	Moduli: Asetet/Mjetet
3	Moduli: Inventaret
4	Moduli: Administrimit i shërbimit të mirembajtjes
5	Moduli: Administrimin e nderhyrjes në vend (field operation)
6	Moduli: Raportimit dhe analizës së tipit BI
7	Moduli: Arkives së Dokumentave teknike të Aseteve
8	Moduli: Administrimit të ceshtjeve (<i>Trouble Ticket System</i>)

(a)

Sistemi i raportimit dhe administrimit të informacionit - ALBPETROL kërkon që vec raporteve standarte që lidhen me Asetet, Inventaret, Nderhyrjet Riparuese, etj. të mundet të zbatojë një sistem të avancuar të administrimit të përqëndruar të raportimit të përgjithshëm të aktivitetit dhe të performancës.

Ky sistem, i raportimit inteligjent i tipit BI, do të ofrojë drejtuesve të ALBPETROL:

- Pamje të përgjithshme dhe të integruar të të gjithë informacionit dhe të treguesve të performancës në sistem;
- Integrim i të gjitha informacioneve që mbahen në sistemet pjesë të këtij projekti (por me mundësi zgjerimi edhe në sistem apo nënsisteme të tjerë që do të zbatohen në të ardhmen);
- Informacion kohor; të agreguar dhe analitik të ecursisë të treguesve të përgjithshëm të performancës në fushën e administrimit të aseteve;

Kërkesa Teknike të detajuara

Sistemi i administrimit të aseteve

Furnizuesi do të ofrojë një program aplikativ për menaxhimin e aseteve dhe shërbimeve të mirembajtjes i cili do të jetë:

- Programi aplikativ duhet të jetë i lehtë në përdorim.
- Veprimet të jenë të qarta dhe të thjeshta për tu kuptuar.
- Proçeset gjatë përdorimit të jenë të shpejta dhe të kuptueshme.
- Duhet të mundesojë kryerjen dhe shfaqjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për administrimin e aseteve si dhe duke regjistruar të gjitha detajet për transaksionet që kryhen mbi të.
- Transaksionet duhet të administrohen pavarësisht vitit ushtrimor financiar.
- Moduli duhet të mundesojë transferimin e aseteve midis qenderave të kostos.
- Programi aplikativ i menaxhimit të stafit dhe shërbimeve operacionale duhet të mbajë (por jo të kufizohet) informacion të detajuar mbi:
 - Kodi i identifikues i Asetit si dhe barcode;
 - Ndertimi i strukture sipas hierarkisë (kompania, vendndodhje, impiante, paisje, mjete dhe komponente)
 - Grupi i postimit të Asetit - Funkcioni përsor dhe me i rëndësishëm i kësaj fushe është lidhja që krijohet ndërmjet asetit dhe llogarive të planit kontabel. Konfigurimet e këtij grupi duhet të kryhen paraprakisht llogarite e blerjes, shitjes, shpenzimit të amortizimit, shpenzimet e mirembajtjes, amortizimit të akumuluar dhe të ardhurat apo humbjet nga shitja e aseteve.
 - Aset i buxhetuar - Informacion që përcakton nëse aset i jete nje aset i buxhetuar apo jo.
 - Sigurimi - Ketu perfshihen nga nje bashkësi të dhenash që përmbajnë informacione me sigurimin e asetit (lloji, arsyeja, primi, afati, etj.).
 - Të dhëna mbi garancinë si prsh. garanci, aftesi, kushtet etj.

- Punonjesi ne ngarkim - praktikisht nepermjet ketij elementi mundesohet lidhja e asetit me personin pergjegjes per perdorimin/administrimin e tij.
- Alokimi ne qendra te Kostos - Element i rendesishem eshte edhe alokimi i asetit nga pikepamja financiare. Ky element perdoret per te realizuar shperndarjen e shpenzimeve te amortizimit sipas njesive administrativo organizative.
- Workflow i venies ne perdorim - Sistemi duhet te mundesoje workflow per venien ne pune te cdo asemi sipas procedurave qe ka ALBPETROL.
- Njoftime automatike- Sistemi duhet te njoftoje perdoruesit perkates nepermjet email per situata te caktuara (si per shernbull koha e rinovimit te garancise, sigurimit, mirembajtjes periodike etj) rreth aktiveve sipas percaktimit dhe konfigurimit qe ben perdoruesi.
- App mobile lejon te njejtat funksione sikurse aplikimi ne kompjuter desktop.
- Veprime nepermjet app mobile - Punonjesi ne terren pasi ka skanuar BAR CODE dote shohet ne ekran informacion rreth asetit dhe aty mund te beje ndryshime tekst te ngarkoje foto.
- App mobile duhet te operoje ne kohe reale me informacionin e ruajtur ne database qendrore.
- Moduli duhet te realizoje proceset e punes te cilat jane te nevojshme per te mundesuar ciklin e veprimeve per administrimin financiar te asetit. Keto procese pune permbledhin, por nuk kufizohen ne procedurat per;
 - amortizimit financiar.
 - rivleresirnin (shtimin/pakesimin si dhe nxjerrjen jashte perdorimit te aseteteve).
 - veprimin e riklasifikimit te asetit.
- Moduli duhet te krijojte automatikisht ditaret mujore per amortizimin dhe rivleresimin e aseteteve.
- Elementet kryesore te procesit te rivleresimit te atributave te asetit te cilat duhet te merren parasysh gjate ndertimit te struktures se ketij moduli duhet te jene :
 - Metoda e Amortizimit. p.sh. lineare, vlera mbetur, vlera e mbartur, etj.
 - Perqindja e Amortizimit.
 - grup asetesh, sipas legjislacionit apo normativave te parashikuara,
 - Date e fillimit te Amortizimit.
 - Data e perfundimit te Amortizimit.
 - Nr. i viteve.
 - Vlera e mbetur.
 - Gjendja (Shitur, dale jashte perdorimit, Joaktiv ose Bllokuar.
 - Oendra Kostos. si dhe
 - Historiku i modifikimit.

Moduli i rregjistrimit te blerjeve

Moduli i blerjeve duhet te mbeshetese procedurat qe lidhen me planifikimin e blerjeve te inventarit ne sistem. Ai duhet te lidhet ne kohe reale me modulin e inventareve nga ku do te marre nevojten per plotesim me inventare (kur inventari eshte nen sasine minimale) si dhe do te perditesoje inventariet me sasine e re te porositur. Njekohesisht per sasite qe planifikohen te levrohen sistemi duhet te perditesoje nje kollone te vecante per sasine e planifikuar.

Me konkretisht Moduli duhet te realizoje:

- Hedhjen ne sistem te urdher blerjeve. Ky document duhet te permbaje te dhenat e artikullit, kodifikimin, sasine ne blerje si dhe cmimet e rena dakord;
- Ruaj gjurme per cdo hyrje ne magazine si dhe sasine e hapur (ende te pafurnizuar);
- Te rregjistruhen te dhenat e furnitorit qe planifikohet te sjell artikujt;

Moduli i administrimit te Inventareve

Moduli i inventareve duhet te realizoje rregjistrimin dhe mbajtjen e inventareve ne magazinat e ndryshme te Albpetrol. Ai duhet te jete plotesisht i integruar me Modulet e tjera, pjese e sistemit. Me konkretisht Moduli duhet te realizoje:

- Krijimin dhe administrimin e vend-ndodhjeve ne magazina sikurse jane raftet, rrjeshtat, katet, etj. Pershire edhe zonat e perpnimit apo te ruajtjes se produkteve te vecanta sikurse mundet te jene vendodhje per palete, zona te kontrollit te mallrave ne hyrje etj..
- Per cdo artikull ne magazine, moduli duhet te mundesoje ruajtjen e numrave seriale, numrave te dergeses si dhe te dateve te skadences, dhe ne veprimet ne magazine sistemi duhet te rekomandoje perdorimin e menyrove te ndryshme artikujve per levizje. Prsh. Nje nga politikat e mundshme ne sistem mundet te jete perdorimi i daljes se artikujve te hyre me heret, ose e artikujve qe kane date skadence me te afert.
- Sistemi duhet te ofroje mundesine e administrimit te nje sasie te pakufizuar magazinash.
- Duhet te percaktoje rregulla per si per hyrjen ashtu edhe per daljen ne magazine. Sikurse mundet te jene zona per inspektimin e artikujve, pregatitjen per dalje, etj. te ngjashem.
- Pregatit dhe miremban dokumentacionin per dalje dhe ne hyrje te materialeve nga magazina. Keto duhet te perfshine dokumenta ne hyrje, urdhe transferimit te brendshem, urdhera per dalje etj. Dokumenta apo operacione te tjera te planifikuara ne sistem jane inventarizimi si dhe evidentimi i diferencave.
- Operacionet magazine perfshire ate te inventarizimit, levizjeve te brendshme si dhe ato te hyrje daljeve duhet te jene te administrueshme edhe nga paisje PDA. Sistemi duhet te jete pershtatur per skanim te barcode direkt nga paisje PDA.
- Per secilin nga artikujt ne magazine, sistemi duhet te lejoje percaktimin e sasise minimale dhe maksimale. Ne rast renie te sasise nen keto percaktime, sistemi duhet te krijoj nje urdher automatik per blerje ne status draft.
- Ne percaktimin e gjendes te inventarit sistemi duhet te mundesoje edhe parashikime per gjendjen ne periodha te ardhshme. Per kete sistemi duhet te mundesoje edhe mbajtjen e koheve te mundeshme te hyrjes se artikujve qe jane pjese e nje urdher blerje.

Moduli i mirembajtjes se aseteve/paisjeve

Per administrimin e mjeteve, sistemi duhet te jete i pershtatur per ndjekjen e mirembajtjes dhe te nderhytjeve. nderhyrje te tilla mundet te jene ato te planifikuara ose ato jashte radhe (riparuese) qe jane si pergjigje e difekteve ne operim. Per cdo nderhyrje sistemi duhet te mbaj gjurme te veprimtarise. Per kete sistemi duhet te mundesoje:

- Ruajtjen dhe planifikimin e nderhyrjeve;
- Ruajtjen e koston dhe veprimtarise ne cdo nderhyrje te mirembajtjes;
- Sistemi duhet te mbaj log te sherbimeve te mirembajtjes, duke percaktuar tipin e mirembajtjes si dhe te dhena specifike teknike qe lidhen me sherbimin. Per cdo nderhyrje mirembajtjeje, sistemi duhet te mundesoje rregjistrimin e faturave, koston se mirembajtjees, furnitoret si dhe data e garancise ne mirembajtjes.
- Sistemi duhet te lidhet me sistemin e administrimit te mirembajtjes ne terren per shkembim automatik te nevojës per mirembajtje dhe njoftimin e operatoreve apo brigadave ne terren.
- Sistemi per cdo nderhyrje mirembajtje duhet te rregjistroje statusin e nderhyrjes, kohet e raportimit, zgjidhjes si dhe te tjera te ngjashme.
- Sistemi duhet te jete i aksesueshem edhe nga paisje PDA, celulare ose Ipad. Te gjitha funksionet duhet te ofrohen ne menyre te njejten pavaresisht mjetit te perdorur per te aksesuar sistemin.

Moduli i administrimit te nderhyrjeve ne vend (field operation)

Moduli duhet te ofroje lehtesi per administrimin e skuadrave te mirembajtjes se aseteve dhe te paisjeve ne terren. Ai duhet te jete i optimizuar per perdorim ne paisje PDA, dhe mobile te cilat perdoren nga skudrat ne terren. Sistemi duhet te mundesoje per keto ekipe, planifikimin, dokumentimin e nderhyrjeve si dhe dokumentin final te nderhyrjeve te realizuara. Punonjesit ne terren mundet te perdorin kete aplikim per cdo info apo dokumentacion shtese qe mundet te duhen me zyrtar. Per kete sistemi duhet te mundesoje:

- Dizenjim te sistemi per perdorim nga paisje mobile, PDA, Ipad te cilat jane te pershtatshme per perdorim ne terren;

- Aksesin ne harte te vendodhjeve te asetit qe kerkohet per mirembajtje. Planifikimin dhe rishikimin e vizitave te mirembajtjes ne baze te optimizimit te levizjeve ne terren;
- Mundesimin e perdorimit te mjetit te komunikimit ne forme chat per te permbledhur ne nje vend aktivitetet dhe komunikimet per zgjidhjen e nderhyrjes se mirembajtjes, sikurse mundet te jene telefonatat, email, takimet, njoftimet shenimet e punes ne cdo detyre ose plan nderhyrje.
- Krijimin automatik te detyrave per nderhyrje ne fushe, nga moduli i raportimit te problemeve (truble tickets) ose sistemi i administrimit te mirembajtjes.

Administrimi i dokumenteve

- Sistemi duhet te ofroje arkivimin e dokumentave, si dhe shtimin e metadata dhe te kategorizimeve te ndryshem per cdo dokument;
- Mundesoje lidhjen e dokumentave me kartelen/dosjet e asetave si dhe kategorizimin e dokumentave;
- Mundesoje editim dhe perpunim te dokumentave pa nevojën e programeve te treta;
- Mundesoje lidhjen e dokumentave me sisteme te tjera te dokumentacionit dhe arkives si Google drive ose Microsoft onedrive;
- Te jap mundesine e percaktimit te drejtave ne nivel dokumenti apo folder te dokumentave;
- Te ofroje sherbimin e ‘koshin’ per ruajtjen e dokumentave per nje minimum kohe 30 dite pas fshirjes. *Koshi* (trash bin) do te mundesoje rikuperimin e dokumentave qe jane fshire gabimisht;
- Mundesoje dergimin e dokumentave direkt me email apo rruge te tjera komunikimi si whatsapp;

Menaxhimi i Përdoruesve (Users)

- Sistemi duhet të mundësojë krijimin, ndryshimin dhe fshirjen e një numri të pafundëm përdoruesish që do aksesojnë sistemin. Keta duhet te jene punonjes, ose aplikante!
- Punonjesit duhet te kene akses ne sistem, per te verifikuar ne menyre te pjesshme (jo cdo e dhene) te dhenat e ruajtura per ta;
- Sistemi duhet të mundësojë një shkallë të lartë *authentikimi* në sistem, qe bazohet ne *multifactor authentication* (MFA);
- Programi aplikativ duhet të mundësojë që të krijohen profile të ndryshme aksesit ne bazë të strukturës së kompanisë. Rolet përkatëse të përcaktohen nga përdoruesi që ka pozicion më të lartë në hierarki. Menu-ja apo funksionet bazë duhet të shfaqen për përdoruesin vetëm atëherë nëse janë lejuar nga supervizori.
- Cdo percaktim i aksesit ne sistem, duhet te aplikohet ne kohe reale ne te gjitha modulet ne sistem. Prsh ndryshimi i strukture organizative te punonjesit te burimeve njerzore, duhet te aplikohet ne kohe reale ne kufizimin sipas pozicionit te ri ne te gjithë modulet e sistemit.

Sistemi i menaxhimit të detyrave “TROUBLE TICKET”

- Sistemi duhet te mundesoje krijimin e ceshtjeve (trouble ticket) nga cdo punonjes.
- Përdoruesit duhet të jenë në gjendje që në çështjet, të kenë mundësi të bashkëngjisin një dokument (file të ndryshme, foto, etj).
- Sistemi duhet të mundësohet menaxhimi i grupeve te mirembajtjes të cileve mund t’i caktohen çështje, duke krijuar për secilin grup një e-mail alias të veçantë, të cilën punonjesit mund ta kontaktojnë direkt.
- Çështjet/detyrat duhet të jetë e mundur t’i caktohen automatikisht në mënyrë të balancuar përdoruesve të brendshëm, në mënyrë të rastësishme, por edhe manualisht nga vetë punonjesit e brendshëm.

- Aksesimi në sistemin e çështjeve të mirembajtjes duhet të kryhet në një ndërfaqe të vecantë, e mundshme për t'u integruar në faqe web të institucionit.
- Sistemi duhet të mundësojë delegimin e detyrave/çështjeve nëpërmjet userave të krijuar në sistemin. Përcaktimi i detyrave bëhet në bazë të strukturës së krijuar duke përfshirë drejtoritë dhe personelin.
- Sistemi duhet të ketë mundësinë e caktimit automatik të çështjeve në varësi të asetit, punonjësit që hap çështjen ose kategorisë së çështjes.
- Duhet të jetë e mundur që çështjeve t'i ndryshohet statusi, p.sh. nga "Në Progres" në "E zgjidhur".
- Sistemi duhet të mundësojë Lajmërimin me SMS dhe Email për çdo delegim apo përcaktim detyre, dhe për çdo përditësim të çështjeve që janë të hapura në këtë modul. Çdo përdorues që ka marrë një çështje në ngarkim duhet të lajmërohet në kohë reale.
- Sistemi duhet të mundësojë që të gjenerojë raporte të ndryshme grafike apo gjenerimin e tyre në file të jashtme si Excel, Word, Pdf etj.
- Sistemi duhet të mundësojë që ky modul të jetë i integruar me përdoruesit që do kenë mundësi aksesimi në këtë platformë.
- Sistemi duhet të lejojë punonjësit të shohin/ndjekin ecurinë e çështjes së tyre, ta editojnë atë apo ta mbyllin nëpërmjet sistemit.
- Sistemi duhet që të ruajë të dhënat gjatë të gjithë kohës në mënyrë të sigurtë.
- Sistemi duhet të mundësojë dashboard për paraqitjen e të gjitha detyrave/çështjeve me qëllim monitorimin e performancës.

Sistemi i raportimit dhe analizës së treguesve

Pjesë e rëndësishme e projektit është ofrimi i modulit të raportimit si dhe analizës. Ky sistem duhet të mundësojë akses të integruar dhe në kohë reale të informacionit në të gjithë modulet në sistemin.

Ndër kërkesat për modulin e raportimit dhe analizës, përmendim:

- Sistemi i raportimit duhet të ofrojë modele të gatshme të analizës mbi modulet e vecanta si dhe menyrën e paraqitjes së tyre në një dritare, raport të përbashët;
- Duhet të mundësohen modele të gatshme analize për modulin e të burimeve njerezore, kontratave, KPI për njësi ose punonjës, etj tregues të ngjashëm. Qëllimi është analiza e thelluar e shumë dimensionale të njësive ose punonjësve, të cilët hapin çështje.
- Sistemi i raportimit duhet të jetë i zgjerueshëm për të krijuar vizualizime në raporte si dhe për t'u lidhur me burime të tjera të dhënash.
- Sistemi i raportimit duhet të jetë intuitiv me qëllim personalizimin e eksperiencës së përdoruesit në sistemin të ngjashëm.
- Sistemi i ofruar duhet të mundësojë dashboard të gatshëm si dhe mundësinë e ndërtimit të tyre nëpërmjet një motori të avancuar raportimi.
- Duhet të mundësohet analizimi i detyrave të ndryshme me qëllim analizimin e performancës së punonjësve apo projekteve.
- Raportet duhet të paraqiten në disa lloje formatesh të ndryshme si format grafik, tabelor ose tabela pivot të cilat mund të eksportohen në formate të ndryshme si .xls etj. Frekuenca e ekstraktimit të këtyre raporteve mund të jetë javore, mujore apo vjetore.
- Lidhur me detyrat/çështjet sistemi duhet të mundësojë vendosjen e standardeve për skuadrat duke krijuar politikat e SLA (kohë pergjigje). SLA-të mund të krijohen në varësi të tipit të çështjes, personit që ka hapur çështje ose të prioritetit të vendosur.
- Sistemi duhet të mundësojë dërgimin e raporteve dhe të analizave direkt me email ose mjete të tjera komunikimi;

SHËRBIMI I ZBATIMIT TË SISTEMIT

Detyrat specifike

Në kuadër të zbatimit të projektit, fazat kryesore të tij janë si mëposhtme:

- **Faza I: Fillimi i zbatimit, dhe raporti i vlerësimit të gjendjes**

Në këtë fazë, operatori ekonomik duhet të bëjë vlerësimin fillestar të gjendjes, procedurat aktuale të administrimit të aseteve dhe të dhenave të ruajtura në sistemet aktuale. Operatori ekonomik duhet të mbledhë informacion mbi mjedisin aktual të aplikimit, duke përfshirë vecoritë, funksionalitetet dhe të vlerësojë vëllimin e veprimeve për migrim.

Pjesë e raportit është edhe ndërtimi i një plani analitik të hapave si dhe burimeve njerezore që kërkojnë.

- **Faza II: Zbatimi i sistemit të perditesuar me të gjithë modulet**

Në këtë fazë, operatori ekonomik duhet të realizojë instalimin e sistemit bazë të burimeve. Ai duhet të bëjë *setup* të sistemit bazë dhe të mundësohet përshtatja me nevojat e ALBPETROL. Si rezultat i kësaj faze, përdoruesit duhet të jenë të gjendje të hedhin në sistem të dhëna të reja dhe të përdorin konfigurimet dhe reportet standarte.

- **Faza III: Konfigurimi i moduleve në sistem, migrimi i të dhenave**

Në këtë fazë, operatori ekonomik duhet të bëjë përshtatjen e sistemit me nevojat specifike të Albpetrol, duke u bazuar mbi kërkesat e mbledhura përgjatë Fazës së parë. Në fund të fazës, sistemi duhet të jetë i gatshëm për operim. Testimet do të kryhen në ambient test të ndërtuar për këtë qëllim. Skenare të testimeve duhet të përcaktohen në fazën e parë dhe të përfshihen në *raportin fillestar*. Sistemi në këtë fazë, duhet të integrohet me sistemin email të ALBPETROL dhe të jetë gatshëm për përdorim.

Gjatë kësaj faze duhet të kryhet edhe migrimi i të dhenave fillestare për popullimin e sistemit.

- **Faza IV: Trajnimi i përdoruesve, vënia në punë.**

Operatori ekonomik duhet të realizojë trajnimin e përdoruesve, të përgatisë materialet udhëzuese, dhe mbi të gjitha të përqendrohet në përshtatjen e biznesit me sistemin e ri. Duhet të përgatiten materialet e trajnimit të punonjësve. Këto materiale duhet të publikohen në portalet e brendshme në sistem.

Afati kohor i implementimit të projektit

Zbatimi i sistemit të administrimit të burimeve në platformën mix Cloud dhe në server të Albpetrol, duhet të kalojë në hapat e mëposhtëm dhe të zgjasë jo më shumë se 4 muaj:

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5		M40
1	Faza Përgatitore Raporti fillestar	X						
2	Zbatimi i sistemit të perditesuar me të gjithë modulet Instalimi i sistemit në të dy ambientet cloud dhe në server lokale;	X						
3	Konfigurimi i moduleve në sistem, migrimi i të dhenave Konfigurimi i të gjithë moduleve, testimi i funksioneve, migrimi i të dhenave dhe përgatitja e manualeve	X	X	X	X			

4	Trajnimi i përdoruesve				X			
5	Fillimi i përdorimit të sistemit,					X	X	X

Testimi i sistemit

Plani i testimit duhet të përmbajë skenarë të detajuar testimi, si edhe të përcaktojë testuesit, aktivitetin e testimit, kriteret e pranimi dhe marrjes në dorëzim. Plani i testimit duhet të nisë e të zhvillohet paralelisht me implementimin e moduleve të ndryshëm.

Ne menyre te vecante do te duhet te testohet secili modul, ne formate te dhenash dhe ne skenare te ndryshem. Përdoruesit e sistemit gjatë testimeve do të jenë personel i ALBPETROL, dhe operatorit ekonomik.

Regjistrimi i të dhënave

Per secilin modul do të jetë e nevojshme të regjistrohen të dhënat e celjes. Operatori ekonomik, së bashku me stafin që ndjek projektin, do të përcaktojnë datën e celjes së sistemit dhe do të bëjnë të mundur fillimin e punës për regjistrimin e të dhënave. Te dhenat qe nuk ekzistojne ne format elektronik standardizuar do te hidhen direkt ne sistem nga punonjesit perkates.

Trajnim stafi

Operatori ekonomik ka për detyrë të identifikojë nevojat për trajnim dhe të mundësojë materialet e nevojshme për trajnimin e përdoruesve. Ai duhet të organizojë trajnimet për stafin menaxherial, përdoruesit e sistemit dhe për administratorët teknik të sistemit. Në fund duhet të dorëzohen të gjitha materialet e trajnimit.

Suporti përgjatë periudhës fillestare të sistemit

Gjatë periudhës fillestare të përdorimit të sistemit duhet të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për përdoruesit e sistemit.

KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Sistemet do të ruajnë ndërveprimet aktuale, por nëse do të ketë nevojë për ndërveprime të tjera pas zhvillimeve të kërkuara, operatori ekonomik fitues duhet t'i realizojë brenda kësaj procedure. Në mënyrë të vecantë, sistemi duhet të komunikojë me sistemet:

- Email për njoftime të ndryshme që lidhen me sistemin
- Marrja e të dhënave të list prezences nga sistemi i kontrolli të hyrjeve.

RAPORTIMI

Kërkesat e Raportimit. Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në origjinal dhe në 2 (dy) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumit 12 faqesh duhet të prodhohet brenda 1 (një) muaji nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura si dhe kryen detajimin e programit të punës apo të vizitave/udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbëhet prej 20 (njëzet) faqesh (teksti kryesor, duke përfshirë anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit final është 5 (pesë) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të

përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi Sistemin. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Raporti i përmendur mësipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Cdo e drejtë mbi kodin burim apo çdo dokumentacion që ka të bëjë **me përmirësimet e zhvilluara në kuadër të kësaj kontrate**, duhet t'i kalojë Autoritetit Kontraktor/përfituesit në format elektronik dhe në letër.

SHËRBIMET E KËRKUARA TË SUPORTIT, SLA

Nivelet e Shërbimit dhe Procesi

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas niveleve të shërbimit dhe metodikës të përshkruar më poshtë, për të gjitha sistemet e përfshira në kontratë.

Suporti i Nivelit të Parë

(a) Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Kompania duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në javë, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha sistemet e listuara në tabelen e Inventarit të Sistemit. Të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes parandaluese.

(b) Shërbime Riparimi

Kompania duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor të operimit të ALBPETROL, në kohëzgjatjen 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar i ALBPETROL ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin "Alarm Madhor" do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të Sistemeve të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me Specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të menjëherëshme e të konsiderueshme të Sistemit dhe që, nuk mund të shmangeshin me anë të ndërhyrjeve dhe riparimeve minore të kryera nga stafi teknik i ALBPETROL dhe të rekomanduara nga Kompania. Problemet që nuk i përkasin "Alarmeve Madhore", duhet të adresohen nën Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese.

(i) **Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore.** ALBPETROL do të njoftojë Kompaninë me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet një ndërfaqeje Web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga Kompania me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Kompania duhet të kontaktojë ALBPETROL-in dhe të konfirmojë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar i AK-së. Në momentin e njohjes së thirrjes nga Kompania, ALBPETROL do të vërë në dispozicion informacione të paracaktuara në Procedurat e Troubleshooting nga Kompania, dhe do ta asistojë atë gjatë diagnostifikimit të problemit të raportuar. ALBPETROL do të koepërojë me kërkesën e Kompanisë për ta ndihmuar atë, në përcaktimin e shkakut të problemit të raportuar dhe në përcaktimin e nevojës për vizitë në vendndodhje për të kryer Shërbimet e Riparimit.

(ii) **Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore.** Nëse kompania nuk mund të përcaktojë nëpërmjet Informacionit të mbledhur nga Procedurat e Troubleshooting, shkakun e Alarmit madhor, atëherë ajo duhet të vendos një Teknik Shërbimi në kontakt të dedikuar me ALBPETROL brenda intervalit kohor prej dy (2) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga ALBPETROL dhe do t'i jepet akses në sistemet e mbuluara pa çënuar sigurinë e të dhënave, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostifikimit dhe riparimit.

(iii) **Veprimtaritë e Diagnostifikimit dhe Riparimit.** Tekniku i shërbimit duhet të fillojë procedurat e diagnostifikimit dhe riparimit. Këto veprimtari duhet të vazhdojnë deri sa (a) Alarmi madhor të jetë korrigjuar ose të jetë “zgjidhur në mënyrë të tërthortë”, (b) tekniku të jetë zëvendësuar nga një person tjetër, (c) Kompania të përcaktojë se problemi i raportuar nuk është shkaktuar nga ndonjë keqfunksionim i Sistemeve të mbuluara ose (d) Kompania arrin në konkluzion që diagnostikimi ose korrigtimi i mëtejshëm mund të shtyhet deri në zëvendësimin e ndonjë paisje lidhëse nga ALBPETROL ose marrjen e rekomandimeve nga Suporti i Nivelit të Dytë.

Suporti i Nivelit të Dytë

Në rast se kompania nuk arrin dot të zgjidhë Alarmin Madhor dhe pas veprimtarive të përshkruara më lart, atëherë ajo duhet të eskalojë problemin tek prodhuesit e komponentëve të sistemit

Teknikët e shërbimit të kompanisë duhet të jenë të trajnuar, certifikuar dhe autorizuar për të ndërvepruar në mënyrë direkte me prodhuesit dhe të mundësojnë zgjidhjen e çdo problemi në afatet kohore minimale. Kompania duhet të ketë punonjës të certifikuar në perputhje me kërkesat specifike të paraqitura më poshtë në këtë dokument **për secilën nga teknologjitë e mësipërme.**

Ata duhet të hapin ceshtjet tek këta prodhues, përshkruajnë problemin teknik që ka shkaktuar alarmin madhor, konsultohen së bashku për të gjetur zgjidhjen e problemit, marrë prej prodhuesve planin e veprimeve dhe rekomandimet për zgjidhje si dhe zbatimin e masave me përpikmëri sipas këtyre rekomandimeve.

Kompania do të paraqesë në ofertë autorizimet e prodhuesve për të demonstruar se ka mbuluar me saktësi të gjithë komponentët e sistemit me suport të Nivelit të Dytë. Të gjitha këto produkte duhet të kenë jetëgjatësinë sipas përcaktimeve në këtë dokument.

Specifikimet teknike për shërbimin e Mirëmbajtjes të Sistemit

Kërkesat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemit janë si më poshtë:

8. Monitorim periodik dhe të rregullt të roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të sistemit. Kompania duhet të ndërmarrë veprime proaktive dhe raportuese në rast të:
 - Ezaurimit të resurseve
 - Mos funksionimit të shërbimeve të instaluar në rolet përkatëse
 - Rritjes së madhësisë së logeve në masën që ndikojnë në performancën e sistemit
 - Performancës dhe disponueshmërisë së ulët të sistemit
9. Verifikimi i i backup automatik të sistemeve.
10. Vlerësim i raporteve të monitorimit dhe përpilim i raporteve për përmirësimin e infrastrukturës.
11. Ndërhyrjet në sistem duhet të propozohen me një akt plan të detajuar për t’u aprovuar. kompania duhet të bëjë ndërhyrjet në kohën e përcaktuar.
12. Kompania duhet të kryejë kontroll periodik javor preventivues, monitores në amjentin cloud të ALBPETROL ose me hyrje “remote të sigurt nëpërmjet VPN”.
13. Kompania duhet të ofrojë suport 24x7 (për probleme kritike, dhe gjatë orarit zyrtar për probleme të tjera) për sistemin financiar duke filluar nga momenti i fillimit të operimit të sistemit, deri në përfundim të kontratës.
14. Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollin e detyrueshme parandaluese dhe preventivuese, si edhe të përshkruajë dinamikën dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.

Shërbimet e Përmirësimit apo modifikimit në Modulet

Kompania fituese duhet të kryejë përmirësime apo modifikime software-i që përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:

6. Azhornimin, përmirësimin dhe modifikimin e sistemit
7. Hostimin e të gjithë sistemeve (kjo nëpërmjet shërbimeve cloud të mbrojtura, nga prodhuesit e sistemeve);
8. Pastrimin dhe konvertimin e të dhënave;
9. Përmirësimi i performancës së proceseve aktuale të sistemeve të përfshira në këtë kontratë;
10. Përmirësimi i raporteve aktuale që prodhohen nga sistemet e përfshira në këtë kontratë sipas kërkesave të institucionit.

Azhornimi, përmirësimi apo modifikimi i sistemit do të bëhet për modulet dhe versionet ekzistuese të përshkruara si komponentë të sistemit. Modifikimet mund të lindin si pasojë e ndryshimeve ligjore ose kërkesave për përmirësime nga përdoruesit etj.

Është i domosdoshëm dokumentimi para dhe pas ndërhyrjeve në sistem.

Shërbime periodike dhe monitorimi i shërbimeve

Kompania duhet të krijojë / diskutojë me ALBPETROL një axhendë periodike kontrollesh si më poshte. Funksionet e mëposhtme në kushtet e sistemeve Cloud, realizohen në një bashkëpunim midis Operatorit Ekonomik dhe Prodhuesit të sistemit:

5. Ditore
 - Monitorimi i statusit të shërbimeve nëpërmjet agjentëve (software monitorimi)
 - Ndërmarrje e aksioneve specifike në rast problemesh të vërejtura.
6. Javore
 - Kontroll i logeve të serverave
 - Të kryejë mirëmbajtje proaktive, nëse rekomandohet nga prodhuesi.
7. Mujore.
 - Testim / kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit
 - Kontroll i log-eve software
 - Përditësim i aplikacioneve në serverat nëse ka përditësime, etj.
 - Rishikim i të dhënave mbi performancën e serverave
8. Përgatitja e raporteve mujore dhe tre mujore mbi problemet, statusin dhe ecurinë e zgjidhjes së tyre, për shërbimet e përfshira në këtë kontratë.

Shërbime të konsulencës

Përgjatë shërbimit të mirëmbajtjes, Kompania duhet të ofrojë gjithashtu shërbimet e mëposhtme të konsulencës.

4. Asistencë për stafin teknik të ALBPETROL në analizën e të dhënave;
5. Asistencë teknike për problemet e lidhura me komunikimin me sisteme apo komponente të infrastrukturës.
6. Dokumentimi i vlerësimit të nevojave, kërkesave të përdoruesit dhe përgatitja e draftit të specifikimeve teknike për ndryshimet që janë pasojë e ndryshimeve ligjore dhe që prekin shërbimet elektronike të përfshira në këtë kontratë.

Trajnimi i personelit teknik:

Kompania fituese duhet të ofrojë në vazhdimësi, shërbime të trajnimit që lidhen me ndryshimet teknologjike të realizuara në sistem apo me ndryshime në strukturën organizative të personelit të ALBPETROL. Trajnimi do të organizohet në klasa të përbëra me 5 punonjës. Këto trajnime duhet të planifikohen të realizohen si trajnime formale me materiale të vecanta trajnimi në formë letër dhe elektronike të përgatitura për këtë qëllim; konfigurimin e kompjuterave që do të shërbejnë për demonstrimin si dhe me një proces formal të vlerësimit të rezultateve pas trajnimit. Për nevojën e përgatitjes së ofertës teknike financiare, kompania duhet të paraqesë së bashku me ofertën teknike metodologjinë e zhvillimit dhe të ndjekjes së trajnimeve ndërsa volumi i përgjithshëm i trajnimeve të planifikuara duhet të jenë si në tabelën e mëposhtme.

Asistencë në vend për çështjet operationale të sistemit

Përgjatë shërbimit të mirëmbajtjes, Kompania duhet të ofrojë një konsulent të dedikuar për sistemin e administrimit burimeve njerzore. Konsulenti, duhet të jetë i certifikuar nga prodhuesi i sistemit dhe duhet të:

- shërbeje si pikë e parë kontakti për personelin e ALBPETROL. Asistenca kërkohet të ofrohet, jo vetëm për çështje që lidhen me mos operimin apo difektet në sistem, por kryesisht me probleme apo asistencë në operimin e sistemit
- mbajë log për asistencën e dhënë;
- përshkallëzojë brenda personelit tjetër të konsulentit, çështje që lidhen me mos funksionimin e rregullt të sistemit; dhe ndjek në vazhdimësi zgjidhjen në kohë të problematikave teknike;
- raportojë në bazë mujore listën e problematikave kryesore të hasura përgjatë shërbimit të asistencës teknike;

Përgjigja si dhe përshkallëzimi i shërbimit

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre. Sigurimi i disponibilitet i sistemit ne cloud duhet të jetë mbi 99.5%.

Serioziteti 1 (Kritik/ i Lartë)	Serioziteti 2 (I Mesëm)	Serioziteti 3 (I Ulët)
Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		
Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime finaciare të mëdha</i> për përdoruesit ose <i>rrezikon shumë aktivitetin ekonomik</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime finaciare të konsiderueshme</i> për përdoruesit ose <i>rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit krijon <i>detyrime financiare minimale</i> për përdoruesit ose <i>rrezikon në mënyrë minimale aktivitetin ekonomik</i> të përdoruesve
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të <i>realizojnë pjesën më të madhe të punës</i> së tyre.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të <i>realizojnë disa pjesë të vogla të punës</i> së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër. Mund të përfshijë gjithashtu pyetje dhe përgjigje për informacion.	Mos funksionimi i aplikacionit pengon përdoruesit të <i>realizojnë një pjesë të vogël të punës</i> së tyre, por ata janë në gjendje të realizojnë pjesën tjetër
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon një numër <i>shumë të vogël</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i aplikacionit ndikon në <i>1 (nje) ose 2 (dy)</i> përdorues
Zgjidhje alternative e përkohshme [Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2]		
<i>Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit (p.sh. puna nuk mund të realizohet në një mënyrë tjetër)</i>	<i>Mund të ketë ose jo një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</i>	<i>Potencialisht ekziston një mënyrë alternative e përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.</i>
Koha e përgjigjes		
Brenda 30 minutave Paraqitja në dispozicion, jo më shumë se 2 orë.	Brenda 6 (gjashtë) orëve ose ditën tjetër të punës.	Brenda 24 (njëzet e katër) orëve ose ditën tjetër të punës.

Koha e Operimit të Suportit		
24 orë përgjatë 7 ditëve të javës	Gjatë orarit zyrtar	Gjatë orarit zyrtar

MJEDISI I TESTIMIT

Kompania duhet të krijojë / konfigurojë mjedisin e testimit për aplikimin e updateve, fikseve apo përditësimeve në software, përpara instalimit të tyre në serverat *production*. Cdo ndërhyrje në infrastrukturën primare të operimit të sistemeve duhet të kryhet vetëm pas testimit të suksesshëm paraprak të ndryshimeve në ambjentet test.

Kompania duhet të monitorojë update që del nga prodhuesi i Software dhe të propozojë pranë ALBPETROL-it përparësitë e implementimeve të tyre. Ajo duhet të kryejë këto përditësime pasi të jetë rënë dakord dhe pas testimit të mundshëm.

ZËRAT E PUNËS, BUXHETIMI

1	2		3	4
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Afati i implementimit (në muaj)
1	License subscription vjetor i sistemit te Aseteve dhe Inventareve (10 Users), per modulet: • Asetet Fikse; • Inventaret; • Blerjet; • Mirembajtja e paisjeve/aseteve dhe supporti ne vend (field operation) me harte nepermjet paisjeve mobile PDA; • Administrimi i perdoruesve, rolet dhe aksest ne sistem; • Raportimit dhe analizës së tipit BI;	Vit	3	2
2	Hostimi i sistemeve ne amjentin cloud te prodhuesit;	Vite	3	1
3	Sherbimi i perditimit të sistemit, përfshirë: - Setup te sistemit; - Celja e te dhenave ne sistemin e ri; - Ndertimi i raporteve;	Set	1	4
4	Trajninin e personelit teknik per sistemin e ri	Klasa	3	1
5	Mirëmbajtja dhe support Sherbimi i suportit dhe mirembajtjes per ceshtje teknike dhe operacionale	Muaj	36	36

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të paslyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

